

PËR MËSUESIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

**Majlinda Haxhikadrija-Ramadani,
Katarina Gojani, Njomza Lila-Babuni,
Valdete Gjakova**

NJERIU DHE NATYRA

Për klasën e dytë të arsimit fillor

2



PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	5
Hyrje.....	7
Planifikimi vjetor.....	14
Plani dymujor: shtator—tetor.....	15
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	21
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	28
Mësimi 1: Kthimi nga pushimet e verës.....	32
Mësimi 2: Prejardhja e materialeve.....	34
Mësimi 3: Lëndët ushqimore - shija, vetitë dhe përbërja.....	36
Mësimi 4: Lëndët higjienike.....	38
Mësimi 5: Gjendjet agregate të materies.....	40
Mësimi 6: Trupat e rregullt dhe të parregullt.....	42
Mësimi 7: Ajri dhe përbërësit kryesorë të tij.....	44
Mësimi 8: Ndotja e ajrit.....	46
Mësimi 9: Mbrojtja e mjedisit është detyrë e secilit prej nesh!.....	48
Mësimi 10: Trupin dhe hapësirën ku mësojmë duhet ta mbajmë të pastër.....	50
Mësimi 11: Vendbanimet e kafshëve.....	52
Mësimi 12: Jeta në lëndinë (livadh).....	54
Mësimi 13: Jeta në fshat.....	56
Mësimi 14: Uji si ambient jetësor për shumë njerëz dhe kafshë.....	58
Mësimi 15: Ne dëshirojmë të ushqehemi shëndetshëm.....	62
Mësimi 16: Ruajtja e ushqimit.....	64
Mësimi 17: Nevojat jetësore të qenieve të gjalla.....	66
Mësimi 18: Vajzat dhe djemtë.....	68
Mësimi 19: Ah, po më dhemb dhëmbi!.....	70
Mësimi 20: Toleranca dhe mirëkuptimi në familje dhe në shoqëri.....	72
Mësimi 21: Gjendja e qetësisë dhe e lëvizjes së trupave.....	74
Mësimi 22: Lëvizja e trupave në tokë, në ujë dhe në ajër.....	76
Mësimi 23: Burimet e zërit.....	78
Mësimi 24: Burimet e dritës.....	80
Mësimi 25: Burimet e nxehtësisë në rrethinën tonë.....	82
Mësimi 26: Toka si burim natyror.....	84
Mësimi 27: Relievi - Format e sipërfaqes së tokës.....	86
Mësimi 28: Ndotësit e mjedisit jetësor.....	88
Mësimi 29: Riciklo dhe ripërdor.....	90
Mësimi 30: Roli i diellit, ajrit dhe ujit për qeniet e gjalla.....	92
Mësimi 31: Të gjithë organizmat e gjallë kanë nevojë për ujë.....	94
Mësimi 32: Ndryshimet ditë-natë.....	96
Mësimi 33: Katër stinët.....	98
Mësimi 34: Po përfundon viti shkollor!.....	100

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënies dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.


Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë gjatë mësimdhënies.
- Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.
- Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zberthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndën dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.
- Metodologjia e mëimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësuesit/et në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mëimit.
- Për të përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mëimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mëimit, ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënësit bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.
- Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mëimit udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.
- Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mëimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës, zërthehen në rezultate të të nxënës. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënës: Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënës të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënës të klasës.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimin: Meqenëse nxënës të klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesi duhet të ndërtojë mësimin mbi të mëparshmen dhe të ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilat sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehjet fillestare të nxënësve që të nxitet interesi i tyre për mësimin.
Pjesa kryesore e mësimin: Mësuesi/ja përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënës të mësimin përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimin kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënës të kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënës të inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

NJERIU DHE NATYRA 2

Fokusi kryesor i të mësuarit në fushën *Shkencat e natyrës* përmban bazën e të kuptuarit të botës përmes koncepteve në lëndën mësimore *Njeriu dhe natyra*. Nxënësit, që në moshë të hershme, njihen me dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë së natyrës.

Në klasën e dytë nxënësit mësojnë për aspektet thelbësore të njohurive, metodave, proceseve dhe përdorimit të shkencës. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ndodh rreth tyre dhe t'i analizojnë shkaktarët.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore, brenda orës mësimore dhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat dhe për fushën *Shkencat e natyrës*, e përkatësisht rezultatet lëndore, paraqesin jo vetëm pika referuese për përzgjedhjen e përmbajtjeve, por edhe për përzgjedhjen e metodologjive, duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve, në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës Kurrikulare.

Suksesi i nxënësve në lëndën *Njeriu dhe natyra* varet nga puna dhe angazhimi i mësuesit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike në laborator, klasë si dhe të nxënësve në natyrë.

Mësimdhënia për nxënësve e klasës së dytë realizohet përmes ilustrimeve, provave dhe lojërave, nën mbikëqyrjen e mësuesit, duke pasur parasysh kohën në dispozicion për nevojat dhe kërkesat e tyre, natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, bazën didaktike dhe stilet e të nxënësve.


Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënësve cilësorë sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësve

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mospërfundimin,

dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxëniet procedurave të mësimdhënies dhe të nxëniet - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndëshi magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxëniet, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxëniet dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënien mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimin të japë rezultate.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhësë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuar në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet) dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëroret etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkohet këshilla/informacione kur has në vështirësi.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një kryerjen (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjell në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njëri nga format shprehëse, si, shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2.	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi/ja apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënit të fushës së Shkencave natyrore Shkalla 1

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHËSITË që zhvillohen	
Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi).	
Nxënësi/ja:	
1.	Vrojton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërrimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme.
2.	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojllojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror.
3.	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale.
4.	Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendosur në lidhmëri me veprimin e forcave.
5.	Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut.
6.	Identifikon mënyrat e orientimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-natyrë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjërë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër.
7.	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).
II. Zhvillimi i shkathësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë	
Nxënësi/ja:	
1.	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.
2.	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.
3.	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjedhen nga mësuesi/ja.
4.	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit).
5.	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim.
6.	Grumbullon dhe mban shënime të cilat i ndihmojnë për të arritur deri te përgjigjet.
7.	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.
III. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen	
<ul style="list-style-type: none"> • Kurreshtja për hulumtimin e botës së gjallë dhe jo të gjallë në natyrë. • Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe përpjekje për të gjetur përgjigje. • Interesimi për të njohur karakteristikat dhe nevojat jetësore të qenieve të gjalla. • Kujdesi për jetën personale, shëndetin e tij dhe të tjerëve. • Kujdesi gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve si dhe respektimi i rregullave të sigurisë gjatë punës. 	
IV. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen	
Identifikim; përshkrim; zbatim; njehsime; matje; skicime; demonstrim; hulumtim modelim; krahasim; vlerësim.	

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shkencat e natyrës
Klasa 2

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1 (Klasa I).
	PERIUDHA I		PERIUDHA II	PERIUDHA III	
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Njeriu dhe natyra	Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj	Marrëdhëniet jetësore	Marrëdhëniet jetësore Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë Mjedisi natyror	Mjedisi natyror Dielli burim i jetës në tokë	Komunikues efektiv I.1, 3, 7; Mendimi kreativ II.1,3, 4, 6, 7, 8 Nxënës i suksesshëm III.1, 2, 3, 4, 6, 7 Komunikues produktiv IV.1, 2, 3, 5, 6 Individ i shëndoshë V.1, 2, 3, 4, 7 Qytetar i përgjegjshëm VI.2,6
	8 orë	8 orë	12 orë	9 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: II

Tema mësimore: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron;
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë;
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Vrojton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërtimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme;
1.3	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.3	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjedhen nga mësuesi/ja;
2.4	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit);
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim;
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon lëndën nga druri, plastika, xhami etj. Në klasë, shkollë, shtëpi - Dallon lëndët ushqimore për nga shija, vetia, për-bërja etj. - Përkruan lëndët higjienike që përdor në jetën e përditshme. - Dallon tri gjendjet agregate të ujit. - Gjen trupat e rregullt dhe të parregullt në mjedisin ku jeton. - Tregon përbërësit kryesorë të ajrit dhe kupton ndikimin e ajrit të pastër për shëndetin. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kthimi nga pushimet e verës 2. Prejardhja e materialeve 3. Lëndët ushqimore - shija, vetitë dhe për-bërja 4. Lëndët higjienike 5. Gjendjet agregate të materies 6. Trupat e rregullt dhe të parregullt 7. Ajri dhe përbërësit kryesorë të tij 8. Ndojta e ajrit 	8	<ul style="list-style-type: none"> - DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Gushëkuqi rrethor - Copëza të përziera - Teknika e pyetjeve - Rrjeti i diskutimit - Parashikim me terma paraprake - Imagjinatë e drejtuar - Kubimi - Shkrim i lirë - Pesëvargësh - Lexim në dyshe - Mësimdhënia reciproke - Të nxënit në bashkëpunim - Mbledhja e të dhënave 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në aktivitete - Listë kontrolli - Semafori - Informata kthyesë - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Buletini i pjesëmarrjes 	<p>Shoqëria dhe mjedisi Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare</p> <p>Edukimi për medie</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p> <p>Globalizmi dhe ndërmarrësia</p>	<p>Njeriu dhe natyra 2</p> <p>Njeriu dhe natyra 2 - fletore pune</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, video-eksperimente)</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p>

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: II

Tema mësimore: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letër, plastelinë, shkopinjë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjella në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
V.3	Bën një listë (me njëriën nga format shprehëse, si, shkrim vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
------	--

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.2	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojllojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror;
1.3	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Marrëdhëniet jetësore	<ul style="list-style-type: none"> - Përkruan rëndësinë e mjedisit të pastër për qeniet e gjalla. - Demonstron mirëmbajtje të higjienës personale si dhe në hapësirë të shkollës/klasës. - Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë. - Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun. - Tregon nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të gjalla. - Dallon ndryshimet biologjike të brendshme dhe të jashtme ndërmjet dy gjinive. 	<ol style="list-style-type: none"> 9. Mbrojtja e mjedisit është detyrë e secilit prej nesh! 10. Trupin dhe hapësirën ku mësojmë duhet ta mbajmë të pastër 11. Vendbanimet e kafshëve 12. Jeta në lëndinë (livadh) 13. Jeta në fshat 14. Uji si ambient jetësor për shumë njerëz dhe kafshë 15. Ne dëshirojmë të ushqehemi shëndetshëm 16. Test vlerësues 	8	<ul style="list-style-type: none"> - DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Gushëkuqi rrethor - Copëza të përziera - Teknika e pyetjeve - Rrjeti i diskutimit - Parashikim me terma paraprake - Imagjinatë e drejtuar - Kubimi - Shkrim i lirë - Pesëvargësh - Lexim në dyshe - Mësimdhënia reciproke - Të nxënit në bashkëpunim - Mbledhja e të dhënave 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja në aktivitete Listë kontrolli Semafori Informata kthyesë Vlerësimi i ndërsjellë Dy yje një dëshirë Vëzhgimi Kontrolli para fluturimit Buletini i pjesëmarrjes 	<ul style="list-style-type: none"> Shoqëria dhe mjedisi Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Jeta dhe Puna Arte Çështjet ndërkurrikulare Edukimi për medie Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm Edukimi për paqe Globalizmi dhe ndërmarrësia 	<ul style="list-style-type: none"> Njeriu dhe natyra 2 Njeriu dhe natyra 2 - fletore pune Paketa e gjelbër Burime nga interneti (filma, dokumentarë, video-eksperimente) Enciklopedi Atlase

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: II

Tema mësimore: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
------------	---

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
-------------	---

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërko-het prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
V.3	Bën një listë (me njërin nga format shprehëse, si, shkrim vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
-------------	--

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.2	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojlojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror;
1.3	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojlojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim.

Tema mësimore: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:**

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshkruan moshën;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
------	---

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar;
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë	
V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron;
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.

Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.2	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojllojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror;
1.3	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim.

Tema mësimore: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
I.1	Lexon me zë një tekst të palëxuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshkruan moshën;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ	
I.1	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e tij;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënës - Nxënës i suksesshëm	
III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëroren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar;
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).
-----	---

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
------	--

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.4	Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendos në lidhmëri me veprimin e forcave;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.4	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit);
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdor fotografi, vizatime, modele dhe metoda tjera.

Tema mësimore: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
------	--

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letër, plastelinë, shkopinjë, ngjyrat, numëroren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).
-----	---

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
------	--

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.5	Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut;
2.3	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjedhen nga mësuesi/ja;
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim;
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda tjera.

Tema mësimore: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.7	Përshkruan në formë të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënës - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).
-----	---

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
------	--

Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.6	Identifikon mënyrat e orjentimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-naturë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjërë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër;
1.7	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore);
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Marrëdhëniet jetësore; Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut; Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve; Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë; Mjedisi natyror;	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun. - Tregon nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të gjalla. - Dallon ndryshimet trupore në mes dy gjinive. - Përdor fjalë korrekte për pjesët e trupit dhe funksionin e tyre. - Kontrollon trupin e vet dhe kujdeset për higjienën trupore. - Identifikon ndryshimet në trupin e vet dhe në rast nevojë kërkon ndihmë. - Tregon tolerancë dhe mirëkuptim në situata të ndjeshme. - Ndërton kontakte sociale dhe krijon shoqëri në grupe shoqërore. - Dallon gjendjen e lëvizjes së trupave nga gjendja e qetësisë me shembuj nga përditshmëria. - Tregon shembuj të lëvizjes së trupave me rënie, ngritje, hedhje, shkelmim, shtyrje, tërheqje etj. - Gjen shembuj nga lojërat, për lëvizje nëpër rrugë të drejtë, rrugë rrethore dhe lëvizje lëkundëse. - Emërton trupa që lëvizin në tokë, në ujë dhe në ajër. - Dallon dhe emërton trupa dhe gjallesa sipas shpejtësisë së lëvizjes së tyre. - Demonstron përfitim të zërit nga burimet e ndryshme. - Emërton burimet e ndryshme të dritës të çfarëdo lloji. - Tregon burime të nxehtësisë të jetës së përditshme. - Përkruan tokën si burim të mirave materiale. - Dallon relievin, klimën, ujërat në tokë përmes vizatimit, përkatësisht fotografive. 	<p>17. Ruajtja e ushqimit</p> <p>18. Nevojat jetësore të qenieve të gjalla.</p> <p>19. Vajzat dhe djemët</p> <p>20. Ah, po më dhemb dhëmbi!</p> <p>21. Toleranca dhe mirëkuptimi në familje dhe në shoqëri</p> <p>22. Gjendja e qetësisë dhe e lëvizjes së trupave</p> <p>23. Lëvizja e trupave në tokë, në ujë dhe në ajër</p> <p>24. Burimet e zërit</p> <p>25. Burimet e dritës</p> <p>26. Burimet e nxehtësisë në rrethinën tonë</p> <p>27. Test vlerësues</p> <p>28. Toka si burim natyror</p>	12	<ul style="list-style-type: none"> - DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Gushëkuq rrethor - Copëza të përziera - Teknika e pyetjeve - Rrjeti i diskutimit - Parashikim me terma paraprake - Imagjinatë e drejtuar - Kubimi - Shkrim i lirë - Pesëvargësh - Lexim në dytshë - Mësimdhënia reciproke - Të nxënit në bashkëpunim - Mbledhja e të dhënave 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në aktivitete - Listë kontrolli - Semafori - Informata kthyesë - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Buletini i pjesëmarrjes 	<p>Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe Puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare</p> <p>Edukimi për medie</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p> <p>Globalizmi dhe ndërmarrësia</p>	<p>Njeriu dhe natyra 2</p> <p>Njeriu dhe natyra 2 - fletore pune</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, video-eksperimente)</p> <p>Burime njerëzore</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p>

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: II

Tema mësimore: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve;

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
-----	--

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

IV.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
------	--

Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.6	Identifikon mënyrat e orjentimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-naturë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjërë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër;
1.7	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore);
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.

Tema mësimore: Dielli, burim i jetës në tokë

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshkruan moshën;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënës - Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letër, plastelinë, shkopinjë, ngjyrat, numëroren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
-----	--

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj;
------	--

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.2	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojlojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror;
1.5	Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut;
1.7	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e Vlerësimit	Metodolo -gjia e mësimdhënies	Nërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Mjedisi natyror</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallon relievin, klimën, ujërat në tokë përmes vizatimit përkatësisht fotografive. - Identifikon ndotësit themelorë të mjedisit si: mbeturinat, fabrikat, automjetet, ujërat e zeza. - Tregon për rolin e diellit, ajrit dhe ujit për jetën në tokë. - Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës. 	<p>29. Relievi - Format e sipërfaqes së tokës</p> <p>30. Ndotësit e mjedisit jetësor</p> <p>31. Riciklo dhe ripërdor</p> <p>32. Roli i diellit, ajrit dhe ujit për qeniet e gjalla</p> <p>33. Të gjithë organizmat e gjallë në tokë kanë nevojë për ujë</p> <p>34. Ndryshimet ditë-natë</p> <p>35. Katër stinët e vitit</p> <p>36. Test vlerësues</p> <p>37. Po përfundon viti shkollor!</p>	9	<ul style="list-style-type: none"> - DRTA - Stuhi mendimesh - Turi i galerisë - Gushëkuqi rrethor - Copëza të përziera - Teknika e pyetjeve - Rrjeti i diskutimit - Parashikim me terma paraprake - Imagjinatë e drejtuar - Kubimi - Shkrim i lirë - Pesëvargësh - Lexim në dyshe - Mësimdhënia reciproke - Të nxënit në bashkëpunim - Mbledhja e të dhënave 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja në aktivitete Listë kontrolli Semafori Informata kthyesë Vlerësimi i ndërsjellë Dy yje një dëshirë Vëzhgimi Kontrolli para fluturimit Buletini i pjesëmarrjes 	<p>Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe Puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare</p> <p>Edukimi për medie</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p> <p>Globalizmi dhe ndërmarrësia</p>	<p>Njeriu dhe natyra 2</p> <p>Njeriu dhe natyra 2 - fletore pune</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, video-eksperimente)</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p>	
<p>Dielli burim i jetës në tokë</p>							

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon lëndën nga druri, plastika, xhami etj. në klasë, shkollë, shtëpi etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.7, II.8; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2.5; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kthimi nga pushimet e verës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan me anë të objekteve të ndryshme përjetimet e tij gjatë pushimeve verore;
- Formulon pyetje për objektet dhe mjediset rreth tij;
- Arsyeton para grupit për zgjedhjen e aktivitetit të tij gjatë pushimeve verore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, laptop, projektor, fletë punuese, ngjyra, ngjitës, gërshtë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Globalizimi dhe ndërvarësia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të vizatojnë një objekt të ndërtuar nga lëndë të ndryshme, si: plastikë, qelq, dru, lëndë ushqimore ose mjedisin natyror i cili u kujton ndonjë moment të veçantë gjatë pushimeve verore. Figura të mundshme mund të jenë: lëngje, lodër, libër, rrush, shalqi, plazh, mal, det, diell, syze etj. Figurat e vizatuara vendosen në këndin e shkencës dhe kështu arrihet te qëllimi i njësive mësimore – *Pushimet verore*.

Hapi 2: Paraqitet një video nga YouTube në këtë vegëz:


https://www.youtube.com/watch?v=V_BnhRJmxtA

Pasi të shikohet videoja, zhvillohet një diskutim me nxënësit për përshkrimin e pushimeve verore. Nxi-ten të bëjnë pyetje dhe të tregojnë ndonjë veprimtari të tyre e cila është e ngjashme me veprimtarinë e personazhit në video.





Kam luajtur në plazh.



Kam vizituar gjyshin dhe gjyshen.




Kam udhëtuar me tren.



Po ti, cilat prej këtyre aktiviteteve i ke përjetuar? Bisedo për pushimet e verës me shokët e shoqet dhe sillni kujtimet më të bukura!

Hapi 3: Ndahen nxënësit në gjashtë grupe. Hapen librat dhe secilit grup i caktohet një mjedis natyror i paraqitur me ilustrime në libër. Nxënësit i shikojnë mjediset e ndryshme natyrore të paraqitura me figura dhe zgjedhin nga një mjedis natyror i cili përshtatet me aktivitetin e tyre gjatë pushimeve. E shkruajnë së bashku në grup.

Hapi 4: Shpërndahen fletë të përgatitura në të cilat nxënësit me anë të vizatimeve të dhëna shkruajnë për vendet që kanë vizituar, ushqimin e preferuar, veprimtaritë që kanë bërë, si dhe shpjegojnë arsyen e këtyre përzgjedhjeve.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të përjetimeve të tyre gjatë pushimeve verore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon lëndën nga druri, plastika, xhami etj. në klasë, shkollë, shtëpi etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.7; I.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.5; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prejardhja e materialeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton objekte që janë krijuar nga materiale natyrore;
- Shpjegon prejardhjen e materialeve natyrore nga bimët, kafshët dhe mineralet;
- Klasifikon objektet natyrore dhe të krijuara nga njeriu.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Mjete shkollore, shishe uji, kuti ushqimi, pambuk, lugë druri, lugë metal, gotë qelqi, gazetë, enë balte, qese najloni, çantë lëkure, kuti kartoni.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit që t'i nxjerrin lapsin dhe gomën nga kutia e lapsave. U shpjegohet se lapsi është i ndërtuar nga druri dhe goma është e ndërtuar nga goma. Druri dhe goma vijnë nga pemët, pra ato janë materiale natyrore. Bimët, kafshët dhe mineralet na ofrojnë materiale natyrore.



Më pas nxënësit i nxjerrin shishet e ujit dhe kutitë e ushqimit mbi bankë. U shpjegohet se ato janë të ndërtuara nga plastika. Njeriu e ka krijuar plastikën nga nafta e papërpunuar. Pra, sendet rreth nesh janë të ndërtuara ose prej materialesh natyrore ose nga dora e njeriut.

Hapi 2: Në një kuti kartoni vendoset pambuk, gotë plastike, vizore druri, lugë metal, lugë druri kuzhine, letër e bardhë, gazetë, kapse letrash, enë balte, enë plastike, gotë qelqi, qese najloni dhe çantë lëkure.

7.7

PREJARDHJA E MATERIALEVE

Ne shohim çdo ditë objekte të ndryshme: ulëse, kosha, shishe, libra etj. Të gjitha këto janë ndërtuar nga materialet. Materialet dallohen për nga: forma dhe vetitë. Disa materiale janë më të forta, p.sh.: druri, guri etj., disa më të buta, p.sh.: pambuku, disa më të rënda, p.sh.: ari, guri, rëra e disa më të lehta, p.sh.: plastika, letra.




Diskuto së bashku me shokët, shodet dhe mësuesin/im për objektet që gjenden në klasë. Trego se prej cilave materiale përbëhen ato.

7.7

PREJARDHJA E MATERIALEVE

Në shohim çdo ditë objekte të ndryshme: ulëse, kasha, shishe, libra etj. Të gjitha këto janë ndërtuar nga materialet. Materialet dallohen për nga: *forma* dhe *vetitë*. Disa materiale janë më të forta, p.sh.: druri, guri etj., disa më të buta, p.sh.: pambuku, disa më të rënda, p.sh.: ari, guri, rëra e disa më të lehta, p.sh.: plastika, letra.



Diskuto së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin/in për objektet që gjenden në klasë. Trego se prej cilave materiale përbëhen ato.

Në tabelë shënohen materialet sipas originës.

Materiale natyrore	Materiale të krijuara nga njeriu

Hapi 3: U shpërndahen nxënësve fletë punuese të përgatitura. Udhëzohen që t'i lidhin materialet sipas prejardhjes së tyre, t'i klasifikojnë ato dhe t'i dallojnë sendet që i përdorin në jetën e përditshme se nga cilat materiale janë të ndërtuara. Vlerësohen përmes listës së kontrollit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në emërtim, shpjegimin e prejardhjes së materialeve dhe klasifikimin e tyre.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon lëndët ushqimore për nga shija, vetia, përbërja etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.4; III.2; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1,3; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Lëndët ushqimore - shija, vetitë dhe përbërja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan ushqimin e preferuar sipas shijes, formës, përbërjes dhe ngjyrës;
- Klasifikon ushqimet e dobishme dhe të dëmshme;
- Vlerëson rolin e ushqimit të shëndetshëm për organizmin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop, fletë punuese, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Pyeten nxënësit:

- A keni ngrënë mëngjes sot?
- Çfarë ndodh nëse jeni të sëmurë dhe nuk mund të hani mëngjes?
- Pse është i rëndësishëm ushqimi?
- Ushqimet që i përdorni a janë të gjitha me shije, ngjyrë dhe formë të njëjtë?


Nga përgjigjet e nxënësve arrihet të qëllimi i orës mësimore, se ushqimet janë të llojllojshme dhe kanë aromë, shije, forma dhe madhësi të ndryshme.

Hapi 2: U shpërndahen nxënësve fletë punuese të përgatitura. Udhëzohen të emërtojnë dhe më pas

7.2

LËNDËT USHQIMORE - SHIJA, VETITË DHE PËRBËRJA

Ushqimi është materie që ka ngjyrë dhe formë. Gjithashtu, ai ka erë, shije dhe temperaturë të ndryshme. P.sh., molla mund të ketë shije të ëmbël ose të thartë, ngjyrë të kuqe, të verdhë, të gjelbër, apo edhe madhësi të ndryshme. Shija e ushqimit varet nga përbërësit që gjenden në të. P.sh., mjalti është i ëmbël, sepse përmban sheqer, djathi është i njelmët, sepse përmban kripë. Ushqimi është i domosdoshëm për jetë.




Diskuto së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesen/in për shijen e ushqimeve të ndryshme që ne përgatitim. To ashtu, diskuto për format, madhësinë, ngjyrën, shijen e frutave dhe perimeve që ne hamë.

1.2

LËNDËT USHQIMORE - SHIJA, VETITË DHE PËRBËRJA

Ushqimi është materie që ka ngjyrë dhe formë. Gjithashtu, ai ka erë, shije dhe temperaturë të ndryshme. P.sh., molla mund të ketë shije të ëmbël ose të thartë, ngjyrë të kuqe, të verdhë, të gjelbër, apo edhe madhësi të ndryshme. Shija e ushqimit varet nga përbërësit që gjenden në të. P.sh., mjalti është i ëmbël, sepse përmban sheqer, djathi është i njelmët, sepse përmban kripë. Ushqimi është i domosdoshëm për jetë.



Diskuto së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin/in për shijen e ushqimeve të ndryshme që ne përgatisim. To ashtu, diskuto për format, madhësinë, ngjyrën, shijen e frutave dhe perimeve që ne hamë.

9

të qarkojnë vetëm ushqimet e tyre të preferuara. Diskutohet së bashku për ushqimet që ata i konsumojnë. Përshkruhen ato sipas formës, ngjyrës, shijes dhe rëndësisë së tyre për shëndetin tonë.



Hapi 3: Nxiten nxënësit të shikojnë një video për ushqimin e shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm, si dhe pasojat e tij në organizmin tonë. Videoja shikohet në vegëzën:
<https://www.youtube.com/watch?v=0X2a7vLUyKk>.

Pasi të shikohet videoja, udhëzohen nxënësit t'i krahasojnë ushqimet që ata i kanë përzgjedhur dhe të shohin nëse janë të shëndetshme apo jo, dhe cilat ushqime duhet t'i heqin nga lista e tyre. Radhiten ushqimet sipas vlerave që kanë për organizmin, duke hequr dorë nga ato të preferuarat, që janë të dëmshme për organizmin.

Ushqimi i shëndetshëm	Ushqimi jo i shëndetshëm

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin, klasifikimin dhe vlerësimin e ushqimeve që konsumojnë.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan lëndët higjienike që përdoren në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: V.1; V.7; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëndët higjienike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan veprimtaritë ditore për mbajtjen e higjienës personale;
- Dallon lëndët higjienike në bazë të përdorimit;
- Shpjegon rolin e lëndëve higjienike për ruajtjen e shëndetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë punuese, mjete shkrimi, fletë vizatimi, ngjyra, ngjitës, gërrshërë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit pyeten:

- Çfarë bëni kur zgjoheni nga gjumi?

Disa nga përgjigjet e mundshme mund të jenë: laj fytyrën, laj dhëmbët, kreh flokët, rregulloj shtratin etj.

- Pse duhet ta mbajmë trupin të pastër?
- Po dhomën tuaj në shtëpi kush e pastron?
- Cilat mjete i përdorim për pastrim?

Nga përgjigjet e tyre arrijmë te qëllimi i orës mësimore.

7.3

LËNDËT
HIGJIENIKE

Higjiena është mbajtja pastër e trupit dhe e mjedisit ku jetojmë. Për këtë qëllim, ne përdorim produkte të ndryshme higjienike.


Trupi është i pastër nëse rregullisht i pastron duart, dhëmbët, flokët, trupin dhe rrobat.

Për pastrim, gati gjithmonë, përdorim ujin, por edhe produkte të tjera higjienike, të cilat e lehtësojnë pastrimin.

Kështu:

- për larjen e duarve dhe të trupit, përdorim sapunin,
- për larjen e dhëmbëve, përdorim brushën dhe pastën e dhëmbëve,
- për larjen e flokëve, përdorim shampun,
- për larjen e rrobave, përdorim sapunin dhe detergjentët etj.

Po ashtu, edhe për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojmë përdorim mjete të ndryshme, si: fshesa, shpuza, detergjentë të ndryshëm etj.



Trego cka përdorim për pastrim.

7.3

LËNDËT HIGJIENIKE

Higjiena është mbajtja pastër e trupit dhe e mjedisit ku jetojmë. Për këtë qëllim, ne përdorim produkte të ndryshme higjienike.

Trupi është i pastër nëse rregullisht i pastrojmë duart, dhëmbët, flokët, trupin dhe rrobat.

Për pastrim, gati gjithmonë, përdorim ujë, por edhe produkte të tjera higjienike, të cilat e lehtësojnë pastrimin.

Kështu:

- për larjen e duarve dhe të trupit, përdorim sapunin,
- për larjen e dhëmbëve, përdorim brushën dhe pastën e dhëmbëve,
- për larjen e flokëve, përdorim shampun,
- për larjen e rrobave, përdorim sapunin dhe detergjentët etj.

Po ashtu, edhe për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojmë përdorim mjete të ndryshme, si: fshesa, shpuza, detergjentë të ndryshëm etj.




Treço çka përdorim për pastrim.

10

Hapi 2: Hapen librat. Shpjegohet rëndësia e mbajtjes pastër të trupit dhe mjedisit rrethues. Shpërndahet fleta punuese dhe nxënësit me radhë emërtojnë lëndën higjienike duke treguar se për çka përdoret ajo.

Theksohet se duhet treguar kujdes gjatë përdorimit të tyre, sepse disa janë të rrezikshme për sytë, pra nuk duhet t'i përdorin ato pa këshillimin me prindër.



Hapi 3: Paraqiten me anë të projektorit fotot e mëposhtme dhe udhëzohen nxënësit t'i vëzhgojnë figurat duke i komentuar mikrobet që gjenden në duart tona gjatë veprimtarive ditore.

Nxiten t'i shpjegojnë pasojat që do t'i kenë në shëndetin e tyre nëse nuk i pastrojnë duart me sapun. I vizatojnë dy duart e tyre, njërin me mikrobe dhe tjetrën të pastruar me sapun.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin, dallimin dhe saktësinë e shpjegimit të rolit të lëndëve higjienike për ruajtjen e shëndetit.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon tri gjendjet agregate të ujit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.4; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.3; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjendjet agregate të ujit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon tri gjendjet agregate të materies;
- Shpjegon dallimin midis materies së lëngët, të ngurtë dhe të gaztë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enë me ujë, kanaçe me pije të ftohtë, një pako lëng, kuti lapsash, kuti ushqimi, libër të trashë, tollumbace, fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit që të shikojnë nëpër klasë dhe të thonë atë që mund të shohin, për shembull: tavolinë, karrige, një kuti lapsash, një shishe uji, një kuti ushqimi etj. Shpjegohet se *çdo objekt në klasë që zë hapësirë dhe ka peshë njihet si materie.*



Hapi 2: Qëndrojnë nxënësit në rreth dhe mbi tavolinë vendoset një enë me ujë, një kanaçe me pije të ftohtë, një pako lëng, një kuti lapsash, një kuti ushqimi, një libër i trashë dhe disa tullumbace, për t'ua

7.4


GJENDJET AGREGATE TË UJIT

Materia mund të ketë tri gjendje agregate: të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë. Uji është e veçmja materie që mund t'i ketë të tria gjendjet (të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë).

E lëngët: kur uji e merr formën e enës ku ndodhet ose vendit ku rjedh, p.sh.: ujë në gotë ose uji në lumin që rjedh etj.

E ngurtë: kur uji ka formën e vet, p.sh.: akulli, dëborë, breshri.

E gaztë: pa formë, i shpërndarë, ku mbush gjithë hapësirën rreth nesh, p.sh.: avulli i ujit.



Uji është lëng pa ngjyrë, pa shije dhe pa erë. Ai mund të shndërrohet nga një gjendje në gjendjen tjetër agregate. Kur e nxehim shumë, uji bëhet avulli dhe përhapet në ajër. Ndërsa, kur e ftohim shumë, ngurtësohet dhe bëhet akulli. Por edhe nga gjendja e akullit dhe e gaztë, mund të kalojë në gjendje të lëngët.



Diskuto së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin për rastet kur uji shndërrohet në gjendje të ngurtë, kur në të lëngët dhe kur në të gaztë.

7.4


GJENDJET AGREGATE TË UJIT

Materia mund të ketë tri gjendje agregate: të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë. Uji është e vetmja materie që mund t'i ketë të tria gjendjet (të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë).

E lëngët: kur uji e merr formën e enës ku ndodhet ose vendit ku rrjedh, p.sh.: ujë në gotë ose uji në lumin që rrjedh etj.

E ngurtë: kur uji ka formën e vet, p.sh.: akulli, dëborë, breshër.

E gaztë: pa formë, i shpërndarë, ku mbush gjithë hapësirën rreth nesh, p.sh.: avulli i ujit.



Uji është lëng pa ngjyrë, pa shije dhe pa erë. Ai mund të shndërrohet nga një gjendje në gjendjen tjetër agregate. Kur e nxehim shumë, uji bëhet avull dhe përhapet në ajër. Ndërsa, kur e ftohim shumë, ngurtësohet dhe bëhet akull. Por edhe nga gjendja e akullit dhe e gaztë, mund të kalojë në gjendje të lëngët.



Diskuto së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin/in për rastet kur uji shndërrohet në gjendje të ngurtë, kur në të lëngët dhe kur në të gaztë.

bërë të qartë atyre ndryshimin midis trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.

Nxënësit më pas duhet t'i klasifikojnë artikujt në të ngurtë dhe të lëngët. Tabela për klasifikim vizatohet në hamer dhe plotësohet së bashku me nxënësit.

Merret ena me ujë dhe derdhet në një gotë ose filxhan. Shpjegohet se uji e merr formën e enës në të cilën ndodhet. Udhëzohen nxënësit të derdhen lëngun në gota. Lëngjet marrin formën e enës ku ndodhen, kanë peshë, derdhen dhe mund të preken.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të vendosin kutinë e lapsave në enë. (Kjo nuk është e mundur.) U tregohet se objektet e forta kanë formë dhe peshë të caktuar. Përshkruhen vetitë e tyre.

Secilit nxënës i jepet nga një tullumbace e zbrazët. E mbajnë atë për të parë se nuk ka asgjë në të. Më pas i fryjnë ato.

- Çfarë ndodh me tullumbacet?

Kërkohet që të shohin si lëvizin ato përderisa e nxjerrin ajrin. Shpjegohet se ajri është i pranishëm kudo rreth nesh. Ajri përbëhet nga gazet, nuk shihet, por ndihet p.sh., kur

vrapojmë ose kur nxjerrim dorën nga dritarja e një makine që lëviz. Oksigjeni është gazi më i rëndësishëm. Pa të gjallesat nuk mund të mbijetojnë.

Hapi 4: U shpërndahen nxënësve fletë punuese dhe detyra është të dallojnë gjendjen agregate të trupave të dhënë. Vlerësohen përmes listës së kontrollit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe të shpjegimit të gjendjes agregate të trupave.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Gjen trupat e rregullt dhe të parregullt në mjedisin ku jeton.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.3; II.4; IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 2.7

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupat e rregullt dhe të parregullt

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon trupat e rregullt dhe të parregullt;
- Shpjegon ndërrimin e formës së trupave në mënyra të ndryshme;
- Klasifikon trupat në bazë të formës së dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Plastelinë, tel, plastikë, brumë, letër, laps druri, karton, ngjyra, materiale recikluese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit tregojnë se nga cilat materiale janë krijuar objektet e ndryshme të klasës. Për shembull, tavolina është prej druri dhe çeliku, çanta e shkollës prej najloni. Shpjegohet se materialet mund të përdoren në mënyra të ndryshme. Merret një copë leckë ose letër. Paloset në gjysmë, dhe përsëri në gjysmë për ta bërë katërshe. Forma e letrës mund të ndryshojë duke e palosur.

Hapi 2: U tregohet nxënësve se për të ndryshuar formën e një guri apo druri duhet të përdoren mjete për t'i prerë. Secilit nxënës i jepet nga një fletë letre me ngjyrë dhe u kërkohet që t'i japin një formë të re duke e prerë. Mund të krijojnë forma të rregullta dhe të parregullta.

7.5

TRUPAT E RREGULLT DHE ATA TË PARREGULLT

Trupat që ndërtohen nga materia kanë formë dhe madhësi të ndryshme. Ata mund të kenë forma të rregullta dhe të parregullta. Forma e rregullt e tyre mund të jetë e rumbullakët, katrore, vezake, në formë pesëcepëshe (në formë të yllit) etj.

Forma të parregullta të trupave mund të jenë:

katrori i parregullt, trekëndëshi i parregullt, pesëkëndëshi i parregullt, gjashtëkëndëshi i parregullt etj.



Trupat e rregullt



Trekëndëshi i parregullt



Katrori i parregullt



Pesëkëndëshi i parregullt



Gjashtëkëndëshi i parregullt



Dil në hapësirë të hapur jashtë shkollës, bashkë me mësuesin/en. Provo t'i shpjegosh format e trupave që sheh.

1.5

TRUPAT E RREGULLT DHE ATA TË PARRREGULLT

Trupat që ndërtohen nga materia kanë forma dhe madhësi të ndryshme. Ata mund të kenë forma të rregullta dhe të parregullta. Forma e rregullt e tyre mund të jetë e rumbullakët, katrore, vezake, në formë pesëcepëshe (në formë të yllit) etj.

Forma të parregullta të trupave mund të jenë:

katrori i parregullt, trekëndëshi i parregullt, pesëkëndëshi i parregullt, gjashtëkëndëshi i parregullt etj.



Trekëndëshi i parregullt



Katrori i parregullt



Pesëkëndëshi i parregullt



Gjashtëkëndëshi i parregullt

Trupat e rregullt



Dil në hapësirë të hapur jashtë shkolles, bashkë me mësuesin/en. Provo t'i shpjegosh format e trupave që sheh.

Sqarohet se forma e disa materialeve mund të ndryshojë duke i përdredhur, shtrirë ose përkulur ato. U kërkohet nxënësve të emërtojnë disa materiale që mund të shtrihen. Diskutohet se si telat mund të jenë të përdredhur dhe tubat plastikë të përkulur.

Hapi 3: Grupet të ndara me nga 5-6 nxënës i zgjedhin materialet e nevojshme dhe modelojnë figura të ndryshme. Kanë mundësi të zgjedhin plastelinë, brumë, kartona me forma të rregullta dhe të parregullta. Luajnë dhe argëtohen duke ua ndryshuar formën materialeve.



Hapi 4: U shpërndahen fletë punuese ku nxënësit i klasifikojnë objektet në bazë të formës së tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në identifikimin, shpjegimin dhe klasifikimin e trupave në bazë të formës së tyre.

Detyrë:

Vizaton tre trupa të rregullt dhe tre trupa të parregullt.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon përbërësit kryesorë të ajrit dhe kupton ndikimin e ajrit të pastër për shëndetin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.1; III.3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;2.1;2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ajri dhe përbërësit kryesorë të tij

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon përbërësit kryesorë të ajrit;
- Demonstron lëvizjen e ajrit nëpërmjet lojës;
- Shpjegon rëndësinë e ajrit për jetën e qenieve të gjalla në planetin Tokë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, laptop, projektor, balona, sodë buke, uthull, shishe plastike, makina lodër, qese najloni, tharëse flokësh, letër A4, gërshtë, shkopinj druri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Paraqitet me anë të projektorit një foto e tortës.

Pyeten nxënësit:

Çfarë bëni për të fikur qiririn mbi tortë?


Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe theksohet se: *ajri është kudo rreth nesh, ne nuk mund ta shohim por mund ta ndiejmë atë.*



7.6

AJRI DHE PËRBËRËSIT KRYESORË TË TIJ

Ajri është i domosdoshëm për jetë të qenieve të gjalla. Ne njerëzit nuk mund të jetojmë pa oksigjen as pesë minuta. Ajrin nuk e shohim, sepse ai është i tejdukshëm. Ajri, po ashtu, nuk ka shije. Është e rëndësishme për shëndetin tonë që ajrin që thithim të jetë i pastër.



Oksigjeni është përbërës kryesor i ajrit pa të cilin nuk mund të jetojnë qeniet e gjalla. Edhe zjarri ka nevojë për ajër. P.sh.: nëse e vendosim një qiri në gotë, flaka e tij do të shuhet ngadalë, sepse sasia e oksigjenit do të harxhohet.




Ti mund ta bësh një eksperiment të tillë në klasë, së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin/en.

1.6

AJRI DHE PËRBËRËSIT KRYESORË TË TIJ

Ajri është i domosdoshëm për jetë të qenieve të gjalla. Ne njerëzit nuk mund të jetojmë pa oksigjen as pesë minuta. Ajrin nuk e shohim, sepse ai është i tejdukshëm. Ajri, po ashtu, nuk ka shije. Është e rëndësishme për shëndetin tonë që ajrin që thithim të jetë i pastër.

Ajri është përzierje e gazeve të ndryshme, si: e oksigjenit, e azotit, e dioksidit të karbonit, si dhe e gazeve të tjera. Përveç tyre, ajri përmban edhe avull dhe pluhur etj.




Oksigjeni është përbërës kryesor i ajrit pa të cilin nuk mund të jetojnë qeniet e gjalla. Edhe zjarri ka nevojë për ajër. P.sh.: nëse e vendosim një qiri në gotë, flaka e tij do të shuhet ngadalë, sepse sasia e oksigjenit do të harxhohet.



Ti mund ta bësh një eksperiment të tillë në klasë, së bashku me shokët, shoqet dhe mësuesin/en.

13

Hapi 2: Shkruhen në tabelë pyetjet:




Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë. U kërkohet që për pak sekonda t'i mbyllin hundën dhe gojën.

Pyeten: - Si u ndiet kur nuk morët frymë?

Hapen librat dhe shpjegohet që:

Ajri është përzierje e gazeve, oksigjenit dhe azotit, në masë të vogël dioksid karbonit. Ajri është materie. Lëvizja e ajrit quhet erë. Ajri ka peshë dhe zë hapësirë.

Hapi 3: Merren mjetet e nevojshme dhe së bashku me nxënësit kryhen këto dy eksperimente për të vërtetuar se ajri zë hapësirë dhe ka peshë. Para eksperimentimit nxënësit parashikojnë dhe më pas i vërtetojnë ato në fletën eksperimentuese.



Hapi 4: Për të demonstruar shtypjen e ajrit nëpërmjet lojës, krijojmë fluturake nga letra dhe lojëra të tjera me balona dhe makina lodër. *Shih figurat më poshtë.*



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrje aktive në demonstrimin e lëvizjes së ajrit.

Detyrë:

Kryen një eksperiment në shtëpi duke vendosur gotën mbi qiri të ndezur. Shpjegon rezultatin.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon përbërësit kryesorë të ajrit dhe kupton ndikimin e ajrit të pastër për shëndetin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.7; 2.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2.5; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e ajrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan faktorët që ndikojnë në ndotjen e ajrit;
- Shpjegon sëmundjet që shkaktohen nga ajri i ndotur;
- Vlerëson rolin e njeriut në mbrojtjen e ajrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop, fletë me ngjyra, qirinj, ilustrime që tregojnë ndotjen e ajrit, ngjyra, gërshërë, ngjitës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Pyeten nxënësit:

- Me se vini deri në shkollë?
- Cilat mjete udhëtimi i përdorni në jetën e përditshme?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë. Pas ndezjes së një qiriri në klasë dhe fikjes së tij, pyeten ata:

- A është ajri i pastër në klasë? Pse?
- Çka e ndoti ajrin?

Hapen dritaret që të ajroset klasa dhe shpjegohet se jemi ne njerëzit që e shkaktojmë ndotjen e ajrit. Mjedisi ku jetojmë duhet të ajroset 2-3 herë në ditë.

Hapi 2: Nxiten nxënësit ta përcjellin me vëmendje video-incizimin për faktorët që e ndotin ajrin në jetën e përditshme. Shikohet videoja në vegëzën më poshtë:

<https://www.youtube.com/watch?v=sAKyhfxxr7s>

1.7

NDOTJA E AJRIT

Si ndotet ajri?

Sot, ajri ndotet në mënyra të ndryshme: nga tymi i makinave, pluhuri, gazet e ndryshme, djegia e disa materialeve etj. Ajri ndotet, po ashtu, kur njerëzit i hedhin mbeturinat në natyrë. Kjo dukuri është shumë e dëmshme për shëndetin, sepse ajri i ndotur mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme në organet e frymëmarrjes të njerëzit dhe kafshët.



Secili prej nesh mund të kontribuojë për mbrojtjen e ambientit. Për shembull, ne mund të udhëtojmë me transport publik ose biçikletë, e më pak ta shfrytëzojmë makinën. Mund të mbjellim më shumë pemë në kopshtet tona etj.



Me çfarë vjen ti në shkollë? Diskuto bashkë me mësuesin/in dhe shokët e shoqët e klasës.



1.7 NDOTJA E AJRIT

Si ndotet ajri?

Sot, ajri ndotet në mënyra të ndryshme: nga tymi i makinave, pluhuri, gazet e ndryshme, djegia e disa materialeve etj. Ajri ndotet, po ashtu, kur njerëzit i hedhin mbelurinat në natyrë. Kjo dukuri është shumë e dëmshme për shëndetin, sepse ajri i ndotur mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme në organet e frymëmarrjes të njerëzit dhe kafshët.

Secili prej nesh mund të kontribuojë për mbrojtjen e ambientit. Për shembull, ne mund të udhëtojmë me transport publik ose biçikletë, e më pak ta shfrytëzojmë makinën. Mund të mbjellim më shumë pemë në kopshtet tona etj.



Me çfarë vjen ti në shkollë? Diskuto bashkë me mësuesin/in dhe shokët e shoqet e klasës.



Pasi të jetë parë ajo, diskutohet me nxënësit për mënyrat e ndotjes së ajrit dhe për ndikimin e njeriut në ndotjen e tij. Shpjegohen sëmundjet që vijnë nga ajri i ndotur, si: asma, kanceri, bronkiti dhe sëmundje të lëkurës.

Në murin e shkencës shkruhen masat që duhen ndërmarrë për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe efekteve negative në formë të kujtesave.

1. Mbillni pemë.

2. Mos ndizni fishekzjarre!

3. Përdorni më shumë transportin publik.

4. Përdorni biçikletën.

Hapi 3: Në fletore pune nxënësit shkruajnë disa shembuj se si mund ta mbrojnë ajrin nga ndotja:



Veprimi im	Pasoja
Unë shkoj në shkollë në këmbë, sepse	makina prodhon gaze që e ndotin ajrin.
Unë mbjell bimë në oborr, sepse	bimët pastrojnë ajrin.
Unë përdor biçikletën, sepse	biçikleta nuk e ndot ajrin.

Hapi 4: Imitojnë me anë të pantomimave se si është toka kur e ndotim ajrin dhe kur e pastrojmë atë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e faktorëve të ndotjes së ajrit dhe shpjegimin e pasojave nga ndotja.

Detyrë:

Shkruan për dëmet që shkakton pirja e duhanit në mjedisin e brendshëm afër fëmijëve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e mjedisit të pastër për qeniet e gjalla.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: III.2; III.4; IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbrojtja e mjedisit është detyrë e secilit prej nesh!

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Gjen frazën e fshehur nga zgjidhja e detyrave;
- Dallon veprimet e dëmshme dhe të dobishme për mjedisin;
- Klasifikon veprimet e dëmshme nga ato jo të dëmshme për mjedisin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune, projektor, kompjuter, altoparlant.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Matematikë, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ora fillon me plotësimin e një flete pune, ku do të bëhet mbedhje dhe zbritje. Për secilën zgjidhje do të jetë një shkronjë përkatëse, p.sh. $13 + 8 = \text{_____} M$, ($21 = M$). Në fund formohet fraza *Mjedis i gjelbër*.

Më pas parashtrohen pyetje:

- Çfarë kuptoni me fjalët mjedis i gjelbër?
- Si mund të mbahet mjedisi i gjelbër?
- Pse është e rëndësishme të jetohet në një mjedis të gjelbër?

Hapi 2: Shikohet një video edukative në të cilën tregohen veprime të ndryshme që mund të ndërmerren që të mbrohet dhe mbahet pastër mjedisi në të cilin jetohet. Vegëza për video:

https://www.youtube.com/watch?v=belXC_IoW4o

2.1

MBROJTJA E MJEDISIT ËSHTË DETYRË E SECILIT PREJ NESH!

Mendo se si mund të kontribuosh edhe ti në mbrojtjen e mjedisit.

Mjedis është hapësira ku jetojnë qeniet e gjalla, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, botën e gjallë.

Në ilustrimet e mëposhtme, mund t'i shihni disa situata ku njerëzit nuk tregojnë kujdes ndaj mjedisit.

Përmes shprehjeve të mëposhtme, këshilloji ata.

1. Mos ndiz zjarr në pyll!
2. Mos hidh mbeturina në natyrë!
3. Mos i shkul lulet! Ato do të thahen!
4. Mos i shkatërro livadhet, sepse shërbejnë si ushqim për kafshët!
5. Mos i dëmto drurët!
6. Trego kujdes ndaj kafshëve!
7. Mos e ndot ujin!

Vini numrat nga 1 deri në 7 në trathë të janë brenda secilit ilustrim.



2.1

MBROJTJA E MJEDISIT ËSHTË DETYRË E SECILIT PREJ NESH!

Mendo se si mund të kontribuosh edhe ti në mbrojtjen e mjedisit.

Mjedi është hapësira ku jetojnë qeniet e gjalla, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, botën e gjallë.

Në ilustrimet e mëposhtme, mund t'i shihni disa situata ku njerëzit nuk tregojnë kujdes ndaj mjedisit.

Përmes shprehjeve të mëposhtme, këshilloji ata.

1. Mos ndiz zjarr në pyll!
2. Mos hidh mbeturina në natyrë!
3. Mos i shkul lulet! Ato do të thahen!
4. Mos i shkatërro livadhet, sepse shërbejnë si ushqim për kafshët!
5. Mos i dëmto drurët!
6. Trego kujdes ndaj kafshëve!
7. Mos e ndot ujin!

Via numrat nga 1 deri në 7 në rrethet që janë brenda secilit ilustrim.



16

Diskutohet rreth videos duke bërë pyetje për veprimet konkrete që mund të bëhen në përditshmëri, veprime këto që mund ta mbrojnë mjedisin ku jetojmë.

Me këtë rast mund të arrihet një pakt në klasë, që nëse fëmijët marrin ujë në shkollë, të kenë me vete një shishe nga qelqi ose termos që të shmangët përdorimi i plastikës dhe hedhja e saj çdo ditë. Gjithashtu të bëhet pas çdo ore ajrosja e klasës, shfrytëzimi i dritës së diellit në vend të asaj elektrike.

Hapi 3: Hapen librat. Lexohet teksti i dhënë. Vrojtohen fotografitë e pastaj plotësohet edhe kërkesa e dhënë në libër ku vihen numrat brenda fotos duke i përshtatur në bazë të numrave të fjalive.

Hapi 4: Në fletën e punës së përgatitur (shih materialin shtesë), do të plotësohet ushtrimi i dytë, ku do të klasifikohen veprimet e dëmshme për mjedisin dhe ato jo të dëmshme. Fotot pritën dhe ngjiten në hapësirat përkatëse. Puna mund të realizohet edhe në dyshe.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në gjetjen e frazës, plotësimin e ushtrimit në libër dhe klasifikimin e veprimeve për mjedisin.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron mirëmbajtje të higjienës personale si dhe në hapësirë të shkollës/klasës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2; II.6; IV.6; V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupin dhe hapësirën ku mësojmë duhet t'i mbajmë të pastër

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e një mjedisi të pastër të punës;
- Rendit veprimet e mbajtjes së higjienës personale dhe të mjedisit;
- Përzgjedh produktet e duhura për mirëmbajtjen e higjienës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pastë, furçë, peshqir, fletë pune, projektor, laptop, altoparlant.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathësi për jetë, Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Bëhet një përsëritje e shkurtër e mësimit të kaluar. Shënohen disa fjali në tabelë me hapësira të zbrazëta. Fjalët që plotësojnë hapësirat e zbrazëta shkruhen në etiketa anash, si në shembullin në vijim:

- _____ e pyjeve shkatërron mjedisin e gjelbër.
- _____ bën që të kemi sa më pak mbeturina.
- Ardhja në shkollë në _____ apo me _____ mban ajrin tonë të pastër.

2.2

TRUPIN DHE HAPËSIRËN KU JETOJMË DUHET T'I MBAJMË TË PASTËR

Ne, çdoherë, duhet të kemi kujdes për mbajtjen e pastërtisë së trupit tonë dhe të hapësirës ku jetojmë. Të jemi të pastër do të thotë të jemi të shëndetshëm. Papastërtia e trupit tonë mund të sjellë sëmundje të ndryshme, sidomos ato të lëkurës.

Shiko ilustrimet e renditura poshtë dhe diskuto me shokët e shoqet në klasë se sa kujdesesh ti për pastërtinë e trupit. Trego se cilat organe mund të dëmtohen nga sëmundjet e papastërtisë së trupit.




2.2

TRUPIN DHE HAPËSIRËN KU JETOJMË DUHET T'I MBAJME TË PASTËR

Ne, çdoherë, duhet të kemi kujdes për mbajtjen e pastërtisë së trupit tonë dhe të hapësirës ku jetojmë. Të jemi të pastër do të thotë të jemi të shëndetshëm. Papastërtia e trupit tonë mund të sjellë sëmundje të ndryshme, sidomos ato të lëkurës.

Shiko ilustrimet e renditura poshtë dhe diskuto me shokët e shoqet në klasë se sa kujdesesh ti për pastërtinë e trupit. Trego se cilat organe mund të dëmtohen nga sëmundjet e papastërtisë së trupit.



Më pas bëhet edhe ushtrimi i dytë si punë në grupe ku nxiten për shkathtësi dhe saktësi. Grupet marrin emra që kanë të bëjnë me higjienën. Arrihet marrëveshja që grupi që do jetë më i pastër gjatë gjithë javës do të shpërblehet me një certifikatë për pastërti dhe rregullsi të mjedisit të punës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në plotësimin e fjalive, shpjegimin e rëndësisë së higjienës dhe plotësimin e fletës së punës.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

çantën e lapsave; librat bashkë me fletoret përkatëse. Pastaj jepen detyra të ndryshme, si p.sh.: *Të merret ngjyra e kuqe dhe të shënohet një fjalë në fletoren Njeriu dhe natyra: Të gjendet fleta e punës nga ora e kaluar.*

Parimisht nxënësi me gjëra të sistemuara do të jetë më i shpejtë dhe i shkathët. Shtrohet pyetja se pse ndodh që nxënësi 2 t'i kryejë detyrat më shpejt se nxënësi 1. Përgjigjet e mundshme: sepse mjedisi i punës së nxënësit të parë ishte i çrregullt e si pasojë do të jetë më i ngadaltë në përfundimin e punëve. Me këtë rast mësohet rëndësia e mbajtjes pastër të mjedisit të punës dhe në mënyrë të rregullt.

Hapi 3: Shikohet një video edukative, e cila përmban hap pas hapi veprimet që janë të nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës personale. Diskutimi shoqërohet me prezantim të mjeteve konkrete: shampo, pastë, furçë, peshqir.

Vegëza për video: <https://www.youtube.com/watch?v=6tuy48RP9kw>

Hapi 4: Hapen librat. Njëkohësisht u jepet një fletë pune, ku duke shikuar librin do të shënohen disa veprime për mbajtjen pastër të higjienës personale dhe mjedisit të punës.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; III.7; VI.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendbanimet e kafshëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mjedisin natyror në bazë të përshkrimit të dëgjuar;
- Klasifikon kafshët sipas vendit ku jetojnë;
- Interpreton zërat e kafshëve të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enciklopedi për kafshë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipë).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të mbyllin sytë, më pas u lexohet një përshkrim i shkurtër për pyllin p.sh.: *Një ditë të bukur fillova një ecje të gjatë. Ec e ec pashë veten që ndodhesha në një mjedis të gjelbër ku më shoqëronin cicërimat e zogjve. Dielli kishte lëshuar rrezet e tij përmes hapësirave të degëve të lisëve të gjatë. Dhelpra bishtbukur bënte shëtijen e saj të mëngjesit. Lepujt e vegjël lëviznin me shpejtësi ngado. Një ketri të vogël i ra nga dora lajthia e vockël që ra mbi kokën time. Iriq gjembaçi kishte shpinën e tij plot me mollë të vogla që i ishin kapur mbi gjëmbat e tij...*

Pas këtij përshkrimi ftohen t'i hapin sytë dhe bëhet pyetja:


- Ku ishte vendi i shëtitjes?

Përgjigje të mundshme: Në mal apo në pyll.

2.3 VENDBANIMET E KAFSHËVE

Kafshët jetojnë në tokë dhe në ujë. Disa lloje jetojnë edhe në tokë, edhe në ujë (për shembull, bretkosat), disa jetojnë në tokë dhe fluturojnë (për shembull, disa lloje të shpendëve). Kafshët e tokës jetojnë në mjedis të ndryshme: për shembull, disa jetojnë në pyje, livadhe, ferma, disa të tjera në shkretëtira etj. Kafshët e ujit pra jetojnë në ujëra të ndryshme: disa jetojnë në lumenj, disa në liqene, ndërsa të tjerat në dete e oqeanë.

Në faqen anash janë dhënë kafshët që jetojnë në mjedis të ndryshme. Me ndihmën e mësueses/it, shenjoni kafshët sipas mjedisve në të cilat jetojnë, duke përdorur figurat përkatëse.



Tokë

Ujë

Ajër

Në bazë të shenjimit të kafshëve që jetojnë në mjedis të ndryshme, shkruaj numrin e kafshëve të tokës: _____, të ujit: _____ dhe të ajrit: _____.



Vazhdohet me pyetje të tjera:

- Pse mendoni që shëtitja u bë në pyll?
- Kush jeton aty?
- Kush cicëronte?
- Cilat kafshë i takova?
- Pse nuk takova një peshk apo peshkaqen?

Hapi 2 : Hapen librat, vrojtohet figura e paraqitur në libër dhe emërtohen kafshët që gjenden aty. Nxiten që të tregojnë edhe emra të kafshëve të tjera. Merren disa enciklopedi për kafshë dhe lexohen informacionet për 2-3 kafshë të pyllit.

Hapi 3: Lexohet informacioni i dhënë në tekst, dhe në detyrën e dhënë nxënësit rrethojnë kafshët e ujit, të tokës dhe të ajrit. Plotësimi i detyrës mund të bëhet në formën zinxhirore, secili me radhë përcakton vendin e kafshës.

Hapi 4: Imitohen në formë loje zërat e kafshëve. Ndahet klasa në tri kolona ose në grupe, varësisht si janë të ulur në klasë. Grupi i parë bëjnë si ujë, grupi i dytë si zogj, grupi i tretë si gjarpërinj. U lexohet një tregim, dhe sa herë përmendet kafsha e përcaktuar fëmijët e imitojnë atë.

Shembull: Në një pyll të madh jetonin disa ujë

(në këtë rast grupi që ka të përcaktuar këtë kafshë fillon dhe ulërin për disa sekonda), pastaj vazhdon tregimi duke i përmendur kafshët e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për gjetjen dhe klasifikimin e mjedisit jetësor të kafshëve, njohuritë e ndryshme për kafshët gjatë diskutimit dhe mënyrën e interpretimit në grup.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; III.7; VI.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Jeta në lëndinë (livadh)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Njeh livadhin dhe specifikat e tij si sipërfaqe tokësore;
- Emërton disa gjallesa që jetojnë në livadh;
- Kategorizon gjallesat që jetojnë mbi dhe nën tokë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, fotografi, fletë pune, laptop, videoprojektor, altoparlant.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Edukatë muzikore, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vizatohet në tabelë një fjalëkryq, ose edhe në hamer paraprakisht. Pyetjet do të jenë horizontalisht, dhe vetëm një fjalë do të jetë vertikalisht. Fjala që do të fitohet vertikalisht do të jetë fjala *livadh*. Në këtë formë arrihet te mësimi *Jeta në livadh*. Shpjegohet se çfarë është livadhi: një sipërfaqe e rrafshët e tokës me shumë gjelbërim, bimë dhe gjallesa të ndryshme.

1.F	L	U	T	U	R	A
2.M	I	U				
	3.V	E	R	A		
	4.A	J	Ë	R		
	5.DH	E				

2.4

JETA NË LËNDINË (LIVADH)

Shiko kafshët në ilustrim dhe trego se cilat prej tyre jetojnë nën sipërfaqe të tokës e cilat mbi. Plotëso më poshtë:

flutura, urithi, kërmilli, blefa, miu, skraja, karkaleci, mollëkuaja, krimbi, merimanga, bretkosa, milingona.

Kafshët që jetojnë në livadh (mbi tokë, mbi bar dhe lule): _____

Kafshët që jetojnë nën tokë: _____



2.4

JETA NË LËNDINË (LIVADH)

Shiko kafshët në ilustrim dhe trego se cilat prej tyre jetojnë në sipërfaqe të tokës e cilat mbi. Plotëso më poshtë:

flutura, urithi, kërmilli, bleta, miu, skraja, karkaleci, mollëkuqja, krimbi, merimanga, bretkosa, mullingona.

Kafshët që jetojnë në livadh (mbi tokë, mbi bar dhe lule): _____

Kafshët që jetojnë nën tokë: _____



Pyetjet horizontalisht:

1. Si quhet një insekt që fluturon, me krahë me ngjyra?
2. Në një film vizatimor kemi macen dhe _____.
3. Cila është stina më e nxehtë e vitit?
4. Çfarë thithim ne kur marrim frymë?
5. Me çfarë e mbulojmë rrënjën e lules kur e mbjellim?

Fjalëkryqi është mirë të jepet i printuar në fletë pune.

Hapi 2: Pas plotësimit të fjalëkryqit, vendoset një foto e printuar në A3, ku shihet livadhi dhe emërtohen disa gjallesa.



Shiko te materiali shtesë

Bëhen pyetje, si: Çfarë shohim në fotografi? Kush mund të jetojë këtu? Ku ndodhen livadhet? Çfarë të mira ka livadhi? Si ofron ushqim për gjallesa? Pse bletët i shohim në livadh? Ke qenë ndonjëherë në një livadh? Çfarë i duhet një livadh që bimët e tij të qëndrojnë të njoma? Njëkohësisht u shpjegohet se fjala livadh është e ngjashme me fjalën lëndinë.

Hapi 3: Hapen librat. Vrojtohet figura dhe bëhet plotësimi i detyrës së dhënë në libër, ku fëmijët dallojnë gjallesat që jetojnë në livadh, mbi tokë dhe ato nën tokë.

Hapi 4: Nxënësit dëgjojnë një këngë, e cila shfaq kafshët dhe pamjet e livadhit. Kënga gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=C6ljGXMMB-g>. df.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në gjetjen e përgjigjeve në fjalëkryq, emërtimin dhe kategorizimin e gjallesave që jetojnë mbi dhe nën tokë.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.7; V.5, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Jeta në fshat

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton emrat e kafshëve që jetojnë në fshat;
- Përshkruan karakteristikat e fshatit, pamjen, gjallesat dhe jetën;
- Klasifikon objektet dhe gjërat e fshatit nga qyteti.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, fotografi të printuara, lodra me kafshë, fletë pune.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u bëhen disa pyetje dhe shkronja e parë e secilës përgjigje do ta gjejë titullin e mësimimit.

- Si quhet vendi ku banojnë kafshët?
- Si quhet objekti ku ju vini çdo ditë për të mësuar?
- Çfarë punon bujku për të mbjellë grurin?
- Si quhet mjete i punës që përdor bujku për të vozitur dhe punuar tokën?



Hapi 2: Secili nxënës do të ketë nga një fletë pune, në të cilën do të jenë edhe disa pyetje të dhëna. Gjatë diskutimit lidhur me pyetjet e mëposhtme, bëhet edhe plotësimi i shënimeve.



2.5 JETA NË FSHAT

Në fshat, ju do të shihni më shumë hapësira të gjelbëruara, sepse aty ka më pak fabrika apo ndërtesa të mëdha sesa në qytet. Kështu, edhe ajri është më i pastër. Në fshat zakonisht mund të gjejmë edhe blegtorë e bujq.

Bisedo në klasë për kafshët që vëh nga ilustrimi lart.



2.5 JETA NË FSHAT

Në fshat, ju do të shihni më shumë hapësira të gjelbëruara, sepse aty ka më pak fabrika apo ndërtesa të mëdha sesa në qytet. Kështu, edhe ajri është më i pastër. Në fshat zakonisht mund të gjejmë edhe blegtorë e bujq.



Bisedo në klasë për kafshët që njihësh nga ilustrimi lart.

21

- Kush jeton në fshat?
- A ke qenë ndonjëherë në fshat?
- Si duket ai?
- Thuhet që jeta në fshat është ndryshe nga qyteti, pse?
- Pse është më i qetë?
- Çfarë të mira sjell fshati për njerëzit e qytetit?

Çfarë pamje ka fshati dhe çfarë mjedise ka ai?	Cilat kafshë jetojnë?	Çfarë kultivohet (mbillet) në fshat?
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Hapi 3: Hapen librat, vrojtohet fotografia dhe plotësohet ushtrimi. Emërtimi i kafshëve bëhet në bashkëpunim me shokun a shoqen e bankës. Në rast vështirësie kërkohet ndihmë dhe shokët e tjerë të klasës ndihmojnë në plotësim të emërtimeve.

Hapi 4: Në tabelë vendosen dy hamera: një me titullin FSHATI, tjetri QYTETI. Aktiviteti bëhet në grupe. Ndahen dy grupe me nga 5 nxënës. Nëpër klasë shpërndahen fotografi të gjërave të fshatit dhe qytetit, si p.sh. ndërtesa të larta, rrugë me makina, livadhe, ara, bujku,

traktori, ferma, kafshë, spital etj. Njëri grup ndahet për t'i kërkuar dhe mbledhur gjërat e qytetit, tjetri të fshatit. Dy anëtarë nga grupi qëndrojnë pranë hamerit për të bërë ngjitjen. Nxënësit e tjerë bëjnë tifo dhe e përcjellin punën. Në fund bëhet prezantimi i tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e plotësimit të ushtrimeve të dhëna si dhe për klasifikimin e tipareve dalluese mes fshatit dhe qytetit.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7; III.2; IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Uji si ambient jetësor për shumë njerëz dhe kafshë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton vendbanimin e gjallesës së dhënë;
- Tregon karakteristikat e përgjithshme të ujit dhe të jetës në të;
- Dallon kafshët nga bimët e ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të printuara, laptop, projektor, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.



2.6

UJI SI AMBIENT JETËSOR PËR SHUMË BIMË DHE KAFSHË

In jeh ti bimët dhe kafshët në ilustrimin e mësipërm? Me ndihmën e mësuesit/es, shkruaj numrat në rathët afër secilës figurë dhe pastaj renditi në tabelë bimët dhe kafshët!

1. Bretkosa 2. Trëndafili i ujit 3. Trofta 4. Shelgu 5. Pllivesa 6. Zambaku i ujit 7. Mjellma 8. Elodea 9. Rosa 10. Kallami.


Bimët	Kafshët

22

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u jepen fotografi me gjallesa të ujit. Fotografia pritet në forma (puzzle). Veprimtaria bëhet në grup. Secili grup duhet t'i rendisë copëzat në formën e duhur, duke krijuar imazhin. Ato i bashkojnë dhe i ngjiten në një fletë duke e emërtuar edhe gjallesën apo pamjen e dhënë.



2.6



UJI SI AMBIENT JETËSOR PËR SHUMË BIMË DHE KAFSHË

Injeh ti bimët dhe kafshët në ilustrimin e mësipërm? Me ndihmën e mësuesit/es, shkruaj numrat në rrethët afër secilës figurë dhe pastaj renditi në tabelë bimët dhe kafshët!

1. Brefkosa 2. Trëndafili i ujit 3. Trofta 4. Shelgu 5. Pllivesa 6. Zambaku i ujit 7. Mjellma 8. Elodea 9. Rosa 10. Kallami.

Bimët	Kafshët

Pas gjetjes së figurës, vendosen në mes lapsat e secilit fëmijë në grup. Në mënyrë rastësore përzgjedhet një laps. Në tabelë del fëmija të cilit i përket lapsi i përzgjedhur dhe prezanton shkurt se çfarë gjallesë është, ku jeton, pra, karakteristikat kryesore.

Në fund bëhet pyetja se çfarë kanë të përbashkët të gjitha këto gjallesa. Përgjigje e mundshme: janë gjallesa të ujit, që jetojnë në ujë. Pastaj u tregohet se do të mësojnë për ujin si mjedis jetësor për shumë bimë dhe kafshë.

Hapi 2: Meqë do të flitet për ujin, rikujtohen disa elemente bazike për ujin dhe rolin e tij duke plotësuar fletën e punës.



Hapi 3: Hapen librat, vrojtohet figura dhe plotësohet detyra sipas kërkesës së dhënë, ku ndahen bimët nga kafshët, si dhe përcaktohen figurat me numra në bazë të llojit përkatës. Diskutohet për rëndësinë e mbajtjes së ujit pastër.

Hapi 4: Ora mund të bëhet edhe më e plotësuar

nëse shoqërohet me një video që tregon më shumë gjallesa të ujit, si për shembull videoja në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=Oxw6FoUNeT4>.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e karakteristikave të ujit, emërtimin e gjallesave dhe plotësimin e ushtrimit.

Detyrë:
Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.2; III.3; V.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Ne dëshirojmë të ushqehemi shëndetshëm

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton ndikimin e llojit të ushqimit në trupin e njeriut;
- Klasifikon ushqimet e shëndetshme nga ato jo të shëndetshme;
- Përshkruan pasojat e ushqimit të pashëndetshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, fotografi të printuara, lodra me kafshë, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vendoset në tabelë një hamer në të cilin janë të vizatuar dy trupa njerëzish: njëra fytyrë është e buzëqeshur, tjetra e mërzitur. Në pjesën tjetër të tabelës vendosen disa figura të ushqimeve të ndryshme: të shëndetshme dhe jo të shëndetshme.




Fëmijët që dalin në tabelë duhet të vendosin se cili ushqim është i shëndetshëm, duke e vendosur figurën e fytyra e buzëqeshur dhe e kundërta.

2.7


NE DËSHIROJMË TË USHQEHEMI SHËNDETSHËM!

Si ushqehen Ortensia dhe Riani? Krahasoj! Shëno cili nga ta ushqehet shëndetshëm?



Shijoni së bashku një shujtë të shëndetshme!


Njeriu ka nevojë për tri shujta kryesore dhe dy meshujta.



Mëngjesi

Meshujta e parë

Dreka



Meshujta e dytë



Darka

Bëje një plan të të ushqyerit shëndetshëm për një ditë.


Mëngjesi:

Meshujta e parë:

Dreka:

Meshujta e dytë:

Darka:




Gjatë kohës sa punohet veprimtaria në tabelë, sugjerohet që edhe fëmijët të shkruajnë në fletore ushqimet e shëndetshme nga ato jo të shëndetshme duke i ndarë në një tabelë:

Ushqimet e shëndetshme	Ushqimet jo të shëndetshme
Molla	Pica
...	...

Hapi 2: Hapen librat. Vrojtohen figurat; krahasohen ushqimet e nxënësve; diskutohet se çfarë hanë dhe kush nga ta ushqehet shëndetshëm.

Hapi 3: Shënohet në tabelë pyetja:

- Çfarë i ndodh trupit tim nëse nuk ha shëndetshëm?



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e ushqimeve dhe pasojat e ushqimit jo të shëndetshëm.

Detyrë:

U përcakohet nga një lloj ushqimi (fruta dhe perime) që do të sjellin në klasë për orën e ardhshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,I.8,II.4,V.3,V.5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.3

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajtja e ushqimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun;
- Demonstron mënyrën e ruajtjes së ushqimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fotografi, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u prezantohet piramida e ushqimit dhe bëhen pyetje:

- Cilat janë ushqimet e shëndetshme?
- Cilat janë ushqimet e pashëndetshme?
- Cili është ushqimi juaj i preferuar?



Hapi 2: Hapen librat, fillon diskutimi me pyetje:

- Si t'i ruajmë ushqimet?
- A e ndani ushqimin me shokët?
- Nëse ushqimi ju tepron, atëherë çfarë bëni me të?

Ja një përgjigje e mundshme: Unë ushqimin e mbetur e vendos në një vend ku edhe të nesërmen mund ta marr me vete; Me atë ushqim ushqej qenin e shokut tim etj.

Në projektor shfaqet një minidokumentar ku merren informacione të përgjithshme se sa fëmijë të uritur

2.8

RUAJTJA E USHQIMIT

Si ta ruajmë ushqimin?

Njerëzit çdo ditë hedhin sasi të madhe të ushqimit ngaqë nuk e ruajnë në vendet e duhura ose për shkak të skadimit të afatit të përdorimit. Shihni më poshtë disa lloje ushqimesh dhe mënyrën se si duhen ruajtur nga prishja:



Makaronat:

Duhen ruajtur në vend të thatë.



Orizi:

Duhet të ruhet në vend të thatë.



Drithërat:

Gjithashtu, duhen ruajtur në vend të thatë.



Çaji, kakaoja dhe kafeja:

Duhen mbyllur mirë, si dhe të ruhen në vend të thatë.



Produktet e ngrira në ngrirës (friz):

Nëse shkrihen një herë, nuk duhen ngrirë për së dyti dhe të përdoren për ushqim. Po ashtu, nëse u ka kaluar afati i përdorimit, nuk duhen përdorur.



Bisedo në klasë me mësuesen/in se se si i ruan ti ushqimet.

2.8

RUAJTJA E USHQIMIT

Si ta ruajmë ushqimin?

Njerëzit çdo ditë hedhin sasi të madhe të ushqimit ngaqë nuk e ruajnë në vendet e duhura ose për shkak të skadimit të afatit të përdorimit. Shihni më poshtë disa lloje ushqimesh dhe mënyrën se si duhen ruajtur nga prishja:



Makaronat:

Duhen ruajtur në vend të thatë.



Orizi:

Duhet të ruhet në vend të thatë.



Drithërat:

Gjithashtu, duhen ruajtur në vend të thatë.



Çaji, kakaoja dhe kafeja:

Duhen mbyllur mirë, si dhe të ruhen në vend të thatë.



Produktet e ngrira në ngrirës (friz):

Nëse shkrihen një herë, nuk duhen ngrirë për së dyti dhe të përdoren për ushqim. Po ashtu, nëse u ka kaluar afati i përdorimit, nuk duhen përdorur.



Bisedo në klasë me mësuesin/in se se si i ruajn ushqimet.

ka nëpër botë.

Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=6K4Nz2wuwO8&t=33s>

Diskutohet rreth minidokumentarit të animuar dhe jepen ide të ndryshme se si do t'i ndihmonin ata të tjerët të ruajnë ushqimet etj.

Po ashtu flitet edhe për Ditën Botërore të Ushqimit (16 Tetor 1945).



Hapi 3: Diskutohet me nxënësit:

- Kur prindërit furnizohen me ushqim, i ndihmoni ata?
- Nëse po, a ju kujtohet ku i vendosni ato?

P.sh. Makaronat i vendosim në dollap, por pse?

Përgjigjja e mundshme:

Duhen ruajtur në vend të thatë.

Kështu me radhë përmendin artikuj ushqimorë duke treguar se ku vendosen ato. Më pas luajnë lojën në treg e cila është e improvizuar në klasë. Ndahen nxënësit në dy grupe: shitësit dhe blerësit. Blerësve u jepen listat e ushqimit

që kanë për të blerë. Më pas u kërkohet që artikujt e blerë të vendosen aty ku mendohet: qumështin në frigorifer, drithërat në dollap e kështu me radhë.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e ushqimeve, mënyrën e demonstrimit të ruajtjes së tyre.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të gjalla.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nevojat jetësore të qenieve të gjalla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon nevojat e qenieve të gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pambuk, fara luledielli, gjethe etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1 : Nxënësit të ndarë në grupe vizatojnë në fletoret e tyre: një njeri, një kafshë dhe një bimë.

Pastaj vizatimet e krijuara i prezantojnë para të tjerëve duke ngjallur diskutim rreth tyre. Pyeten:

- Çfarë na nevojitet neve që të rritemi?
- Po kafshët dhe bimët, për çfarë kanë nevojë?





Hapi 2: Hapen librat, lexohet teksti.

Shfaqen disa video ku tregohet se çfarë u nevojitet bimëve, kafshëve dhe njeriut për jetë. Më pas komentohen ato. Në fund identifikohen nevojat, pa të cilat qeniet e gjalla nuk mund të jetojnë.

Videot gjenden në vegëzat:


https://www.youtube.com/watch?v=k4UD-f3tF_O4

<https://www.youtube.com/watch?v=dUBIQ1f-TRzI>

<https://www.youtube.com/watch?v=fLj260g-sw60>



Hapi 3: Nxënësve u shpërndahet: letër, pambuk, fara luledielli, gjethe dhe me to punohen nevojat jetësore të qenieve të gjalla që janë: **DIELLI, UJI, USHQIMI, AJRI.**



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për punën e tyre në identifikimin e nevojave të qenieve të gjalla, si dhe për pjesëmarrje aktive në diskutim.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:

- Dallon ndryshimet trupore në mes dy gjinive;
- Përdor fjalë korrekte për pjesët e trupit dhe funksionin e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1, III.2, V.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, II.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vajzat dhe djemtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon pjesët e trupit;
- Tregon funksionin e pjesëve të trupit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop, fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Matematikë, Shkathësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë muzikore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Formohet një rreth me nxënës dhe bashkërisht me ta fillojmë me numërimin e pjesëve të trupit duke treguar se çfarë funksioni kryejnë ato. P.sh. sytë - me sy shikojmë; këmbët - me këmbë ecim a vrapojmë; veshët përmes veshëve dëgjojmë, e kështu me radhë.




Hapi 2: Hapen librat. Dëgjohet historia e Tinës dhe e familjes së saj. Më pas diskuton secili për veten dhe familjen e vet.

2.70

VAJZAT DHE DJEMTË

Cilat pjesë të trupit i njeh tit? Çfarë funksione kanë ato?



Diskuto me të tjerët në klasë për pjesët e trupit!

Këta janë prindërit e Tinës. Ata e presin lindjen e një fëmije.
Fëmija rritet për nëntë muaj në barkun e nënës.



Kur të lindë fëmija,
ka nevojë për
shumë dashuri dhe
përkujdesje.

A ke ndonjë vëlla ose motër? Nëse po, si quhet ai/ajo? _____

29

- Sa anëtarë ka familja ime?
- Sa vëllezër dhe motra kam?
- A janë ata më të mëdhenj apo më të vegjël se ne?



Hapi 3: Nxënësve u shpërndahen fletët dhe u kërkohet që t'i presin pjesët e trupit për të ndër-tuar me to figurën e njeriut. Gjatë veprimtarisë dëgjohet kënga “Trupi im” në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=yRtE0VNppvY>.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për aktivitetin që ka të bëjë me identifikimin e pjesëve të trupit dhe funksionin e tyre.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Kontrollon trupin e vet dhe kujdeset për higjienën trupore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,III.1,III.2,III.3,V.1, VI.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4,1.3,2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ah, po më dhemb dhëmbi!

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rëndësinë e kujdesit për dhëmbët;
- Përshkruan procesin e pastrimit të dhëmbëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pambuk, pecetë me ngjyra, plastelinë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u prezantohet njësia mësimore dhe i kërkohet secilit nga ata të mendojë nga një pyetje.


Ja një shembull i tillë:

- Sa dhëmbë kemi?
- Sa shpesh duhet ta vizitojmë stomatologun (dentistin)?
- Cilat janë mjetet e punës me të cilat ju punoni?

Ftohet stomatologia në klasë. Flitet për dhëmbët, funksionin dhe mirëmbajtjen e tyre. Nxënësit pyesin dhe marrin përgjigjet e duhura nga ajo.


2.11

"AH, PO MË
DHEMB
DHËMBI!"




Adriani ka dhembje të dhëmbit.
 A thua ai nuk i ka pastruar dhëmbët ashtu si duhet?
 Ndoshta ai nuk ka shkuar me rregull te dentisti.
 Nëse keni dhembje, skuqje apo ënjtje, kërkoni ndihmë mjekësore!


Ju duhet të shkoni së paku dy herë në vit te dentisti për kontroll të dhëmbëve. Po ashtu, duhet t'i pastroni dhëmbët së paku dy herë në ditë, nga dy minuta. Më poshtë mund të shihni mënyrën e duhur se si t'i pastroni dhëmbët:




Pastraje pjesën e përparme të dhëmbëve me lëvizje rrethore.




Pastraje pjesën e brendshme të dhëmbëve nga mishit i dhëmbëve - poshtë.




Pastraje hapësirën në mes të dhëmbëve dhe mishit të dhëmbëve poshtë.



Pastraje sipërfaqen përtpypëse të dhëmbëve me lëvizje të drejta.



Pastraje pjesën e përparme të dhëmbëve me lëvizje të drejta.



Merri një brushë dhëmbësh në klasë dhe trego se si i pastron dhëmbët ti.

30

2.11

"AH, PO MË DHEMB DHEMBI!"



Adriani ka dhembje të dhëmbit.


A thua ai nuk i ka pastruar dhëmbët ashtu si duhet? Ndoshita ai nuk ka shkuar me rregull te dentisti.

Nëse keni dhembje, skuqje apo ënjtje, kërkoni ndihmë mjekësore!

Ju duhet të shkoni së paku dy herë në vit te dentisti për kontroll të dhëmbëve. Po ashtu, duhet t'i pastroni dhëmbët së paku dy herë në ditë, nga dy minuta. Më poshtë mund të shihni mënyrën e duhur se si t'i pastroni dhëmbët:




Pastroje pjesën e përparme të dhëmbëve me lëvizje rrethore.




Pastroje pjesën e brendshme të dhëmbëve nga mishi i dhëmbëve - poshtë.



Pastroje hapësirën në mes të dhëmbëve dhe mishi të dhëmbëve poshtë.



Pastroje sipërfaqen përtpëse të dhëmbëve me lëvizje të drejta.




Pastroje pjesën e përparme të dhëmbëve me lëvizje të drejta.



Merr një krushë dhëmbësh në klasë dhe trego se si i pastron dhëmbët ti.

Hapi 2: Në mungesë të dentistes, hapen librat, dhe përmes projektorit paraqitet një video ku u tregohet se si duhet bërë pastrimi i dhëmbëve. Kliko në vegëzën: https://www.youtube.com/results?search_query=si+te+pastrojme+dhembet+per+femije



Hapi 3: Nxënësve u shpërndahen fletë të bardha dhe peceta me ngjyrë të bardhë dhe të zezë, si dhe fletët ku janë të vizatuara dhëmbët. Më pas, përmes plastelinës modelohen format e dhëmbëve dhe vendosen te numrat përkatës që janë në fletën e punës.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në bashkëbisedim me stomatologun, rëndësinë e kujdesit për dhëmbët dhe përshkrimin e procesit të pastrimit të dhëmbëve.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:

- Identifikon ndryshimet në trup dhe në rast nevojë kërkon ndihmë;
- Tregon tolerancë dhe mirëkuptim në situata të ndjeshme;
- Ndërton kontakte sociale dhe krijon shoqëri në grupe.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,I.7,IV.3,V.6,VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.7,2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Raportet e shëndosha shoqërore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krahason sjelljen e mirë dhe të gabuar;
- Identifikon raportet e shëndosha shoqërore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të vizatojnë shokun a shoqen e bankës. Më pas ta prezantojnë atë që kanë vizatuar duke treguar se çfarë e bën atë të veçantë.



2.12

TOLERANCA DHE MIRËKUPTIMI NË FAMILJE DHE SHOQËRI

Secili prej jush ka mendime të ndryshme. Duhet ta respektoni mendimin e tjetrit, edhe kur nuk ju pëlqen. Kjo është toleranca. Në lagje dhe në shkollë, vazhdimisht mund të bësh miq të rinj duke qenë tolerant dhe mirëkuptues.



Duke u shoqëruar mes vete, ju argëtoheni dhe mësoni shumëçka nga njëri-tjetri. Duhet t'i respektoni të gjithë shokët dhe shoqet.



Raportet e mira, toleranca dhe mirëkuptimi në familje dhe shoqëri duhet të ruhen çdoherë.



Trego si vepron ti kur një shok ose shoqe ka nevojë për ndihmën tënde.

32

Hapi 2: Të ulur në rreth zhvillohet bisedë mbi atë se sa e duam, si e ndihmojmë dhe sa e respektojmë njëri-tjetrin.

Veprimet ndahen në dy kolona:

Kolona 1: Shënohen veprimet pozitive ndaj njëri-tjetrit.

Kolona 2: Shënohen veprimet negative ndaj njëri-tjetrit.

Fjali të mundshme:

Duhet ndihmuar njëri-tjetrin;

Nuk duhet ta vëmë në lojë njëri-tjetrin;

Duhet të luajmë së bashku;

Nuk duhet të zihemi me njëri-tjetrin etj.



Hapi 3: U shpërndahen nxënësve fletë dhe i kërkohet secilit të vizatojë dorën. Brenda dorës së paraqitur japin mendime se çfarë i bën ata shokë të mirë. Ja ilustrimi i mëposhtëm.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për krahasimin e sjelljeve, identifikimin e raporteve, punën individuale dhe grupe, si dhe për punën praktike.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon gjendjen e lëvizjes së trupave nga gjendja e qetësisë me shembuj nga përditshmëria.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1 III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Gjendja e qetësisë dhe e lëvizjes së trupave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mënyrën e lëvizjes së trupave në përditshmëri;
- Përshkruan ilustrimet duke përdorur shprehjet: lëvizje rrethore, lëvizje para, prapa etj.;
- Klasifikon objektet sipas mënyrës së lëvizjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Litar, top, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit e klasës ndahen në katër grupe. Secili grup do të praktikojë një ushtrim të caktuar. Grupi 1 - bëjnë tërheqjen e litarit; grupi 2 - hedhjen e topit në kosh; grupi 3 - kërcim si bretkosa lart-poshtë; dhe grupi 4 - qëndrojnë të ulur duke medituar. Veprimtaria zhvillohet në sallën e edukatës fizike. Ushtrimet praktikohen 2-3 herë nga nxënësit.

Hapi 2: Hapet diskutimi me pyetjet:

- Si u ndiet gjatë ushtrimeve?
- Çfarë ndodhi me trupin tuaj gjatë praktikimit të ushtrimeve?

3.1

GJENDJA E QETËSISË DHE E LËVIZJES SË TRUPAVE

Disa trupa nuk lëvizin; ata janë në qetësi. Trupat e tjerë mund të lëvizin, domethënë, mund ta ndërojnë pozitën. Procesi i zhvendosjes nga një pozitë në tjetrën quhet lëvizje. Lëvizjet mund të jenë të ndryshme: para, mbrapa, në rreth, lëkundëse, poshtë-lart etj.

Trupat mund t'i lëvizim me anë të forcës në mënyra të ndryshme, si për shembull, nëse i hedhim nga lartësia, nëse i ngremë, i shtyjme, i tërheqim etj. Disa trupa lëvizin ngadalë, të tjerët lëvizin shpejt. Shpejtësia tregon se sa shpejt një trup e ndëron pozitën.



Trupat në lëvizje



Me shokët e shoqet e klasës dinë mësuesen/in, krahasojë një trup që është në qetësi me një trup që është në lëvizje në klasën tuaj.

3.7

GJENDJA E QETËSISË DHE E LËVIZJES SË TRUPAVE

Disa trupa nuk lëvizin; ata janë në qetësi. Trupat e tjerë mund të lëvizin, domethënë, mund ta ndërronin pozitën. Procesi i zhvendosjes nga një pozitë në tjetrën quhet lëvizje. Lëvizjet mund të jenë të ndryshme: para, mbrapa, në rreth, lëkundëse, poshtë-lart etj.

Trupat mund t'i lëvizim me anë të forcës në mënyra të ndryshme, si për shembull: nëse i hedhim nga lartësia, nëse i ngremë, i shtyjmë, i tërheqim etj. Disa trupa lëvizin ngadalë, të tjerët lëvizin shpejt. Shpejtësia tregon se sa shpejt një trup e ndërron pozitën.



Trupat në lëvizje



Me shokët e shoqet e klasës dhe mësuesin/in, krahaso një trup që është në qetësi me një trup që është në lëvizje në klasën tuaj.

- A mendoni se lëvizi trupi juaj?
- Bashkë me ju, kush tjetër lëvizi?
- Çfarë lëvizje bënte trupi gjatë ushtrimeve?
- Cilët trupa ishin në qetësi?

Ja disa përgjigje të mundshme: Trupi lëvizte gjatë ushtrimeve; Bashkë me ne lëviznin litari, topi, duart; Ishin trupa në qetësi, trupat bënin lëvizje poshtë-lart, tërheqje dhe shtytje me litar etj.

Hapi 3: Nxënësit i shikojnë ilustrimet e paraqitura në libër dhe i përshkruajnë trupat sipas mënyrës së lëvizjes.

Teksohet që zhvendosja e trupave nga një pozitë në tjetrën quhet *lëvizje*. Lëvizjet mund të jenë të ndryshme: para, mbrapa, në rreth, lëkundëse, lart, poshtë etj. Trupat mund t'i lëvizim në mënyra të ndryshme, për shembull: hedhja e topit, tërheqja e litarit, shtytja e bankës.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në fletore pune ushtrimin e dhënë. Plotësohen vendet e zbrazëta brenda fotos sipas mënyrës së lëvizjes. Gjatë shkrimit, përdorin shprehjet, si: lëvizje rrethore, lëvizje lart dhe poshtë, objekt në

qetësi, lëvizje para dhe mbrapa.

Hapi 5: Nxënësit plotësojnë tabelën duke u bazuar në ilustrim, ku shënojnë trupat që bëjnë lëvizje rrethore, para dhe mbrapa, lart dhe poshtë si dhe trupa në qetësi. Më pas e ngjyrosin sipas dëshirës ilustrimin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, dallimin e trupave në lëvizje dhe qetësi, përshkrimin e ilustrimeve, klasifikimin e objekteve sipas mënyrës së lëvizjes.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton trupa që lëvizin në tokë, në ujë dhe në ajër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; II.4; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 2.4, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Lëvizja e trupave në tokë, në ujë dhe në ajër

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon trupat që lëvizin dhe janë në qetësi;
- Identifikon tupat që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër;
- Klasifikon trupat sipas vendit të lëvizjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxiten nxënësit të tregojnë mënyrën e lëvizjes së trupave, nga njësia e kaluar. Shtrohen pyetje të tilla, si:


- Si qëndrojnë trupat në natyrë?
- Kur themi që një trup është në lëvizje?
- Si mund të lëvizin trupat?
- Kur themi që një trup është në qetësi?

Trego dy shembuj nga jeta e përditshme të lëvizjes së trupave. Ja disa përgjigje të mundshme: Trupat në natyrë qëndrojnë në qetësi dhe lëvizje. Trupat lëvizin para, mbrapa, poshtë, lart etj.

3.2

LËVIZJA E TRUPAVE NË TOKË, NË UJË DHE NË AJËR

Ndër kafshët më të shpejta në planet janë: gepardi, delfini dhe shqiponja. Ndër kafshët më të ngadalshme janë: breshka, krimbi dhe kërmilli. Shkruani emrat e kafshëve të dhëna në ilustrime:



Shkruaj emrin e një kafshe që lëviz në tokë, një në ujë dhe një në ajër:

Automjetet e ndryshme mund të lëvizin në tokë, ujë dhe ajër.

Shëno nën figurën përkatëse: ec, lundron, fluturon dhe shëno shpejt ose ngadalë.

Traktor



Aeroplan



Helikopter



Automobil



Autobus



Anije kozmike



Varkë



36

Hapi 2: Nxënësve të ndarë në 4 grupe u shpërndahen fletë A4 me ilustrime të mjeteve të udhëtimit.

Grupi 1 – Cilat nga mjetet e udhëtimit kanë karakteristika të ngjashme dhe mund të grupohen së bashku? (mund t'i grupojnë sipas formës, fortësisë, shpejtësisë, ngjyrës);

Grupi 2 – Identifikojnë cilat mjete të udhëtimit lëvizin ngadalë, më shpejt;


Grupi 3 – I klasifikojnë mjetet e udhëtimit sipas mënyrës së lëvizjes (lart, poshtë, lëvizje rrethore, tërheqje);

Grupi 4 – I identifikojnë dhe i klasifikojnë mjetet e udhëtimit që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër.

Hapi 3: Secili grup paraqet gjetjet e veta para klasës duke dëshmuar me anë të fotos, mënyrës tabelare, vizatimeve apo me shkrim. Diskutohet që trupat mund të lëvizin në tokë, ujë dhe ajër. Pyeten: Cilët trupa të tjerë mund të lëvizin në tokë, ujë dhe ajër?

Nxënësit emërtojnë trupa të tjerë që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit në dyshe, të gjejnë dhe të shkruajnë të veçantat dhe të përbashkëtat e trupave që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, emërtimin e trupave që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër, identifikimin dhe klasifikimin e trupave që lëvizin në tokë, ujë dhe ajër.

Detyrë:

Plotëson kërkesën e dhënë në fletë pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Demonstron përfitimin e zërit nga burimet e ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.8, II.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.3, 2.4, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Burimet e zërit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton burimet e zërit;
- Modelon me materiale të dhëna instrumente që prodhojnë zë;
- Demonstron burimin e zërit me instrumentet e krijuara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjitës, shkopinj, balona, kanaçe, llastik, lugë plastike, kapak.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë muzikore, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetjeve të shtruar, si:

- Si keni mësuar të flisni?
- Pse flasim ne?
- Si e kuptoni që një njeri flet me ju?
- Nga vjen zëri?

Ja disa përgjigje të mundshme:

Kam filluar të flas duke i imituar tingujt e të tjerëve. Përmes zërit dhe mimikës kuptoj kur të tjerët flasin me mua. Zëri vjen nga dridhja e kordave të fytit etj.

3.3

BURIMET E ZËRIT

Zëri është lloj i valës, i cili krijohet kur trupat dridhen (vibrojnë). Kur trupat dridhen, dridhet dhe ajri rreth tij dhe kështu krijohet zëri, të cilin e dëgjoni me anë të veshëve.

Burimet e zërit mund të jenë natyrore, siç janë ato nga qeniet e gjalla, era, lumenjtë etj. dhe nga mjete të ndryshme të krijuara nga njeriu.

Zëri mund të jetë i lartë dhe i ulët, p.sh.: një këngë ju mund ta këndonit me zë të lartë ose të ulët. Zërat e lartë shpesh mund të jenë të pakëndshëm dhe shqetësues për t'u dëgjuar. Zërat e fillë quhen zhurmë.



Bisedo me shokët e shoqet e klasës për burimet e zërit dhe trego cilat janë më të zhurmshmet.

3.3 BURIMET E ZËRIT

Zëri është lloj i valës, i cili krijohet kur trupat dridhen (vibrojnë). Kur trupat dridhen, dridhet dhe ajri rreth tij dhe kështu krijohet zëri, të cilin e dëgjoni me anë të veshëve.

Burimet e zërit mund të jenë natyrore, siç janë ato nga qeniet e gjalla, era, lumenjtë etj. dhe nga mjete të ndryshme të krijuara nga njeriu.

Zëri mund të jetë i lartë dhe i ulët, p.sh.: një këngë ju mund ta këndonit me zë të lartë ose të ulët. Zërat e lartë shpesh mund të jenë të pakëndshëm dhe shqetësues për t'u dëgjuar. Zërat e fillë quhen zhurmë.



Bisedo me shokët e shoqet e klasës për burimet e zërit dhe trego cilat janë më të zhurmshmit.

37

Pra, zëri është lloj i valës, i cili krijohet kur trupat dridhen. Zërin mund ta dëgjojmë përmes veshit.

Zëri mund të jetë i lartë dhe i ulët.

Hapi 2: Duke u bazuar në ilustrimet e paraqitura në libër, nxënësit emërtojnë burimet e zërit. Cilat janë burimet e zërit? Nga cilët trupa mund të fitojmë zë-tinguj? Ja një përgjigje e mundshme: Zërat vijnë nga makinat, dridhjet, pasimi i topit, kitara, telat, sirenat etj.

Hapi 3: Nxënësit e klasës ndahen në 4 grupe. Secili grup krijon instrumente që lëshojnë zë. Puna në grupe bëhet duke ndjekur udhëzime të dhëna me anë të fletës A4.


Grupi 1. Punojnë kitarën me materiale: ngjitës, kapak, shkop, llastik, ngjitës me ngjyrë.

Grupi 2. Modelon lodër me materiale: lugë plastike, ngjitës zbukurues, kuti, "kinder ve", oriz.

Grupi 3. Modelon daulle me materiale: balonë, kanaçe, shkop, ngjitës.

Grupi 4. Modelon instrument frymor (harmonikë goje) me materiale: shkopinj, ngjitës, llastik.

Hapi 4: Nxënësit demonstrojnë para klasës, trupat e krijuar që prodhojnë zë. I krahasojnë zërat që prodhohen nga instrumentet e krijuara, se cili zë është më i lartë, më i ulët, më i fortë e më i butë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, emërtimin e burimeve të zërit, modelimin e instrumenteve që prodhojnë zë, demonstrimin e instrumentit të modeluar.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Emërton burimet e ndryshme të dritës të çfarëdo lloji.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Burimet e dritës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton së paku dy burime të dritës;
- Dallon burimet natyrore dhe artificiale të dritës;
- Identifikon burimet e dritës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime me burime të dritës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Para nxënësve paraqiten tri ilustrime. Diskutohet me ata se ku dallojnë njëra nga tjetra? A na duhen në jetën e përditshme dielli, llamba dhe qiriri? Pse?



Këto janë burime të dritës, që e ndriçojnë mjedisin ku jetojmë.




3.4



BURIMET E DRITËS

Drita është formë e energjisë, e cila na mundëson të shohim. Ajo vjen në mënyrë natyrore nga Dielli dhe yjet e tjera, si dhe vetëlimja. Ka dhe disa kafshë që mund të bëjnë dritë, siç janë xixëllonjat p.sh. Drita krijohet edhe nga burime artificiale të prodhuara nga njeriu, siç janë: qirinjtë, llambat e ndryshme, shkrepësi, zjarri etj. Drita mund të depërtojë nëpër disa objekte, si xhami, uji, ajri etj., prandaj e përdorim xhamin në dritare, që dhomat të jenë të ndriçuara.


Disa objekte janë të padepërtueshme për dritën; ato bëjnë hije.



Bisedo me të tjerët për burimet e dritës dhe trego si t'i shfrytëzoni ato në shtëpitë tuaja.

Hapi 2: U kërkohet nxënësve që të emërtojnë burime të dritës nga jeta e përditshme. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Shembull:



Pra, burim drite është gjithçka që krijon ose jep dritë. Nga shembujt e dhënë, vërehet që kemi burime të ndryshme të dritës.

- Ku dallojnë burimet nga njëra-tjetra?

Disa janë burime natyrore të dritës, që janë krijuar nga natyra, ndërsa burimi artificial i dritës është ai burim i dritës që është krijuar nga njeriu.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të vështrojnë ilustrimin e paraqitur në libër. Përshkruhen burimet e dritës që janë në dhomë (ilustrimin) dhe klasifikohen në burime natyrore dhe artificiale.

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të plotësojnë në fletore pune. Poshtë secilit ilustrim shkruajnë emrat e tyre. Shembull:



Dielli



yjet



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për gjetjen e dy e më shumë burimeve të dritës, dallimin e burimeve natyrore dhe artificiale të dritës, identifikimin e ilustrimeve të dhëna.

Detyrë:

Vizatoni tri burime të dritës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Tregon burime të nxehtësisë në jetën e përditshme (të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7; II.1; II.4; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.5, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
 Burimet e nxehtësisë në rrethinën tonë

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon së paku dy burime të nxehtësisë;
 - Dallon burimet e nxehtësisë natyrore dhe artificiale;
 - Përshkruan rëndësinë e burimeve të nxehtësisë në jetë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Udhëzohen nxënësit të rreshtohen për dy. Me radhë, secili prej tyre do të kërcejë pupthi deri te caku, më pas kthehet te vendi i nisjes duke i dhënë mundësinë nxënësit tjetër të vazhdojë kërcimin. Veprimtaria përfundon kur nxënësi i fundit i rreshtit praktikon kërcimin.

Pas përfundimit të veprimtarisë shtrohet pyetja:

- A mendoni që trupi juaj po liron nxehtësi? Pse?
- A mund të themi që trupi i njeriut është burim i nxehtësisë?

Pra, nxehtësia krijohet nga trupi i njeriut gjatë fërkimit të duarve, aktivizimit të muskujve në lojë etj.

3.5

BURIMET E NXEHTËSISË NË RRETHINËN TONË

Nxehtësia është formë e energjisë, e cila vjen nga Dielli. Dielli ngroh tokën, ujin, ajrin dhe objektet e tjera në sipërfaqe të tokës. Nxehtësia bartet nga vendet dhe objektet e ngrohta, te vendet ose objektet e ftohta.

Përpos Diellit, nxehtësia mund të vijë edhe nga burime të tjera, si p.sh.: zjarri. P.sh. kur gatuojmë: druri digjet dhe, kështu, krijohet zjarri. Nga zjarri krijohet nxehtësia, përmes së cilës ne ziejmë ose ngrohim ushqimin.

Nxehtësi krijon edhe trupi juaj. Kur vraponi ose luani, ai nxehet. Po ashtu, nëse fërkoni duart, ato do të nxehen.



Si mund ta shfrytëzojmë energjinë e diellit?

Pos për ngrohje, energjinë e diellit mund ta shfrytëzojmë edhe për qëllime të tjera, si p.sh.: për të prodhuar energji elektrike. Kjo mund të bëhet përmes paneleve solare. Ato e shndërrojnë energjinë e diellit në energji elektrike. Prodhimi i rrymës në këtë formë e ruan mjedisin, sepse nuk i ndot ajrin, ujin apo tokën.

Diskuto për burimet e nxehtësisë që i shfrytëzojmë në shtëpinë tënde.



3.5

BURIMET E NXEHTËSISË NË RRETHINËN TONË

Nxehtësia është formë e energjisë, e cila vjen nga Dielli. Dielli ngroh tokën, ujin, ajrin dhe objektet e tjera në sipërfaqe të tokës. Nxehtësia bartet nga vendet dhe objektet e ngrohta, te vendet ose objektet e ftohta.

Përpos Diellit, nxehtësia mund të vijë edhe nga burime të tjera, si p.sh.: zjarri. P.sh. kur gatujmë: druri digjet dhe, kështu, krijohet zjarri. Nga zjarri krijohet nxehtësia, përmes së cilës ne ziejmë ose ngrohim ushqimin.


Nxehtësi krijon edhe trupin juaj. Kur vraponi ose luani, ai nxehet. Po ashtu, nëse fërkoni duart, ato do të nxehen.



Si mund ta shfrytëzojmë energjinë e diellit?

Pos për ngrohje, energjinë e diellit mund ta shfrytëzojmë edhe për qëllime të tjera, si p.sh.: për të prodhuar energji elektrike. Kjo mund të bëhet përmes paneleve solare. Ato e shndërrojnë energjinë e diellit në energji elektrike. Prodhimi i rrymës në këtë formë e ruan mjedisin, sepse nuk i ndot ajrin, ujin apo tokën.

Diskuto për burimet e nxehtësisë që i shfrytëzojmë në shtëpinë tënde.



- A mendoni që dielli i ngroh të gjithë njerëzit në planetin Tokë?
- Në çfarë gjendje janë burimet e nxehtësisë të përmendura deri më tani? (Të lëngët, të gaztë dhe të ngurtë).

Hapi 5: Pas diskutimit, u kërkohet nxënësve të vizatojnë dhe të emërtojnë burimet e nxehtësisë të përmendura gjatë diskutimeve. Vizatimet bëhen në fletë A4, dhe secili nxënës vizaton një burim të nxehtësisë. Punimet ekspozohen dhe komentohen para klasës. Pas komentimit, bashkohen të gjitha fletët dhe krijohet një libërth me burime të nxehtësisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari; për njohjen e së paku dy burimeve të nxehtësisë, të saj, si dhe për rëndësinë në jetë të tyre.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Hapi 2: Diskutohet me nxënësit në klasë duke shtruar pyetjen:

- Cilat janë burimet e nxehtësisë në jetën e përditshme?

Ja disa përgjigje të mundshme:

Burim i nxehtësisë është dielli, rryma elektrike, zjarri, fërkimi i trupave, stufa, hekuri për hekuosje, qiri, llamba etj.

Pra, nxehtësia është formë e energjisë, e cila vjen nga dielli, zjarri, rryma, stufa etj.

Hapi 3: Theksohet që, nxehtësia e diellit ka rëndësi të madhe për tokën, pasi e ngroh tokën, ujin ajrin dhe objektet e tjera. Dielli është burim natyror i nxehtësisë.

Udhëzohen nxënësit t'i shikojnë ilustrimet e paraqitura në libër, më pas të përshkruajnë me fjalë burimet e nxehtësisë dhe rëndësinë e tyre në jetën e përditshme.

Hapi 4: Nxiten nxënësit të shprehin mendime rreth burimeve të nxehtësisë, për rolin dhe rëndësinë e tyre në jetë.

- A janë të njëjta burimet e nxehtësisë për nga përbërja? Pse?
- A e mendoni jetën pa diell?
- Si do të ishte jeta nëse nuk do të kishim burime të nxehtësisë?

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan tokën si burim i të mirave materiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, II.1, III.2, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toka si burim natyror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton burimet natyrore të tokës;
- Përshkruan tokën si burim i të mirave materiale në jetën tonë;
- Pasuron fjalorin me përdorimin e fjalëve: dhe, gur, bimë, kafshë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësve u lexohet një tekst i shkurtër përmes të cilit do të gjejnë se për çfarë bëhet fjalë.

Vendi ku nis çdo gjë, aty ku jeta fillon e dielli na ngroh.
 Vendi ku njerëzit jetojnë, kafshët veprojnë dhe bimët lulëzojnë.
 Vendi ku nata bëhet ditë, e drita e diellit bëhet burim i nxehtësisë.
 A e dini kush jam unë? (TOKA).
 Nxiten nxënësit të japin mendime, derisa të gjejnë se për kë bëhet fjalë.

Hapi 2: Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secili grup punon sipas udhëzimeve të dhëna, si më poshtë:

- Grupi 1. Përshkruajnë përbërjen e tokës (dheu, gurët, uji, ajri).
- Grupi 2. Shkruajnë kafshët që jetojnë në tokë dhe dobitë që sjellin ato.
- Grupi 3. Nxënësit vizatojnë se çfarë marrim ne nga toka.




4.7 TOKA SI BURIM NATYROR

Toka është planeti i vetëm në të cilin mund të zhvillohet jeta. Kjo ndodh sepse mbi dhe nën sipërfaqe të tokës ka burime të rëndësishme materiale që mund t'i shfrytëzojmë ne dhe qeniet e tjera të gjalla. Një pjesë e sipërfaqes së Tokës është e përbërë nga dheu dhe gurët, ndërsa sipërfaqja më e madhe e saj është e mbuluar me ujë (lumenjtë, liqenet, detet dhe oqeanet). Në sipërfaqe të tokës rriten bimë, të cilat shërbejnë si ushqim për kafshët. Shumë bimë dhe kafshë janë ushqim për njerëzit. Pas ushqimit, nga toka marrim edhe të mira të tjera, të cilat i quajmë burime natyrore. Kështu, nga toka e marrim ujin, i cili na nevojitet për nevoja të përditshme, marrim minerale të ndryshme, p.sh., rërën, gurët, metale të ndryshme, por edhe lëndë djegëse energjetike si naftë, gaz, thengjill etj.



Diskuto në klasë me mësuesen/in dhe shokët e shoqet e klasës se cilat nga bimët dhe kafshët i njeh ti.



4.7 TOKA SI BURIM NATYROR

Toka është planeti i vetëm në të cilin mund të zhvillohet jeta. Kjo ndodh sepse mbi dhe nën sipërfaqe të tokës ka burime të rëndësishme materiale që mund t'i shfrytëzojmë ne dhe qeniet e tjera të gjalla. Një pjesë e sipërfaqes së Tokës është e përbërë nga dheu dhe gurët, ndërsa sipërfaqja më e madhe e saj është e mbuluar me ujë (lumenjtë, liqenet, detet dhe oqeanet). Në sipërfaqe të tokës mifin bimë, të cilat shërbejnë si ushqim për kafshët. Shumë bimë dhe kafshë janë ushqim për njerëzit. Pas ushqimit, nga toka marrim edhe të mira të tjera, të cilat i quajmë burime natyrore. Kështu, nga toka e marrim ujin, i cili na nevojitet për nevoja të përditshme, marrim minerale të ndryshme, p.sh., rërën, gurët, metale të ndryshme, por edhe lëndë djegëse energjetike si naftë, gaz, thëngjill etj.



Diskuto në klasë me mësuesen/in dhe shokët e shoqet e klasës se cilat nga bimët dhe kafshët i vjen t'i.

41

Grupi 4. Shkruajnë disa lloje bimësh që rriten në tokë dhe dobitë e tyre për jetën e kafshëve dhe të njerëzve.


Puna në grupe shoqërohet me foto, si ndihmesë gjatë punës.

Hapi 3: Grupet paraqesin gjetjet e veta rreth temës dhe i diskutojnë me nxënësit e tjerë në klasë.

Toka është burim për njerëzit, kafshët dhe bimët. Në tokë rriten bimët që u shërbejnë kafshëve për ushqim. Bimët dhe kafshët janë ushqim për njerëzit. Nga toka marrim edhe të mira të tjera, si: ujin, gurët, drurët, plastika, goma, metale të ndryshme, letra etj. Këto të mira i quajmë burime natyrore.



Drurët



Uji



Gurët



Metale të ndryshme

Hapi 4: Nxënësit pasurojnë fjalorin me fjalët e dhëna: kafshë, bimë, dhe, gurë, pemë, perime, mish, ujë). Toka është burim për njerëzit, _____.
Toka përbëhet nga _____.
Nga toka marrim _____.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për gjetjen e së paku dy karakteristikave të tokës, emërtimin e burimeve natyrore të tokës, përshkrimin me fjalë të ilustrimit, pasurimin e fjalorit me përdorimin e tyre në fjali.

Detyrë:

Shkruan tri fjali për tokën, si burim natyror i të mirave materiale.

Reflektim për rrezjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon relievin, klimën, ujërat në tokë, përmes vizatimit, përkatësisht fotografive.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.7, II.6; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.7; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Relievi - Format e sipërfaqes së tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton mjediset natyrore sipas figurës;
- Përshkruan me fjalë mjedisin natyror të paraqitur në libër;
- Shpjegon karakteristikat e klimës në mjedise natyrore;
- Klasifikon mjediset natyrore me ujë dhe tokë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Luhet loja e shoqërimit, ku udhëzohen nxënësit të ndahen në 4 grupe. Secili grup zgjedh përfaqësuesin e grupit. Loja luhet duke u bazuar në rregullat e vendosura më parë, si:

1. Grupet marrin fjalën me radhë duke diskutuar paraprakisht me anëtarët e grupit.
2. Kur hapet një katror, kanë të drejtë të shprehin mendime për zgjidhje të kolonës apo zgjidhjen përfundimtare të shoqërimit.
3. Përgjigjet jepen nga përfaqësuesit e grupit.

4.2

RELIEVI - FORMAT E SIPËRFAQES SË TOKËS

Shkruaj nën secilën figurë emrin përkatës.



Sipërfaqja e tokës ka forma të ndryshme. Varësisht nga forma, pjesa e sipërfaqes së tokës merr edhe emërtime të ndryshme, si p.sh.: mal, kodër, luginë, vulkan etj. Po ashtu, në sipërfaqe të tokës ka edhe sisteme të ndryshme ujore, si p.sh.: lumi, liqeni, ishulli, deti etj.

Kodra - është pjesë e ngritur e sipërfaqes së tokës; tokë që ka një majë të rumbullakosur dhe pjerrësi që mund të jetë e madhe apo dhe e vogël.

Mali - është një pjesë e ngritur e sipërfaqes së tokës, kryesisht me anë të pjerrëta që përbëhet nga shkëmbinjë. Është më i lartë se kodra. Në shpesh e quajmë edhe bjeshkë.

Lugina - është një hapësirë midis bjeshkëve a kodrave, nëpër të cilën në shumicën e rasteve rrjedh ndonjë lumë.


Fusha - një sipërfaqe toke e hapur, e mbjellë me drithëra, perime etj. ose është kulturë.

Vulkani - pjesë e ngritur e tokës që krijohet prej shpërthimeve që vijnë nga brendësia e tokës.

Ishulli - është pjesë e tokës që rrethohet nga të gjitha anët me ujë.



Dislatxo për kodrat, malet, luginat, fushat, lumenjtë, ujëvarat, liqenct, që gjenden në rrethimin e vendbanimit tënd.



Lumi - rrjedhë e ujit që përbëhet nga burimi, rrjedha e sipërme, e mesme, e poshtme - që derdhet në det.

Ujëvara - vend ku uji bie prej një lartësie (zakonisht në lumenj, në degë të tyre, në përranj apo edhe në disa liqene).

Moçali - sipërfaqe e lagësht e tokës nga ujëra të ndenjura me thellësi të vogël.

Liqeni - sipërfaqe e madhe e tokës, e mbushur me ujë dhe e rrethuar nga të gjitha anët me tokë.

Deti - sipërfaqe shumë e madhe e mbushur me ujë të kripur, një pjesë e së cilës është e rrethuar me tokë.

Shëno emrin përkatës në secilin ilustrim.

A	B	C	D
dardha	domatja	banesë	luani
molla	speci	shtëpi	tigri
ananas	karrota	dyqan	dhelpra
pemë	perime	themel	kafshë
TOKA			

Hapi 2: Shtrohet pyetja:

- Toka, ka sipërfaqe të njëjtë apo të ndryshme?

Ja një përgjigje e mundshme: Sipërfaqja e tokës ka forma të ndryshme: të rrafshta, të thella, me ujë, me rërë etj. Zhvillohet diskutimi, nxënësit shkëmbejnë

mendimet me njëri-tjetrin.

Theksohet që toka ka forma të ndryshme, varësisht nga forma, pjesa e sipërfaqes së tokës merr emërtime të ndryshme.

Kalohet në veprimtarinë e radhës.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit t'i shikojnë ilustrimet e paraqitura në libër, të cilat më pas përshkruhen prej tyre.

Shembull:

Kodra është sipërfaqe e ngritur e tokës; Bjeshka është pjesë shumë e ngritur e sipërfaqes së tokës etj. Vazhdohet në këtë formë deri te përshkrimi i ilustrimit të fundit.

Shtrohen pyetje për diskutim: Çfarë klime mund të jetë në këto mjedise natyrore? A mund

të zhvillohet jeta në këto mjedise?

Hapi 4: Kalohet në veprimtarinë e radhës. Nxënësit punojnë në dyshe, ku i klasifikojnë mjediset natyrore të mbuluara me ujë dhe rërë, shkëmbinj etj., në fletë A4.

Format e sipërfaqes së tokës me dhe, rërë, shkëmbinj etj.	Format e sipërfaqes së tokës të mbushura me ujë.
Kodra, bjeshka, mali, ishulli, vullkani, kontinenti.	Lumi, ujëvara, moçali, liqeni, deti.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, emërtimin e sipërfaqeve të tokës, përshkrimin dhe klasifikimin e tyre, si dhe shpjegimin e karakteristikave të klimës.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndotësit themelorë të mjedisit, si: mbeturinat, fabrikat, automjetet, ujërat e zeza.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, III.3, IV.2

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.7, 2.1, 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotësit e mjedisit jetësor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mesazhin e fotos së paraqitur;
- Identifikon ndotësit e mjedisit jetësor;
- Shpjegon rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Formulon së paku tri fjali këshilluese për mbrojtjen e mjedisit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Para nxënësve paraqitet një foto. Kërkohet nga ata të tregojnë se çfarë shohin në foto.

- Çfarë mesazhi përcjell ilustrimi i paraqitur?
- A mendoni që toka është në duart tona?



4.3

NDOTËSIT E MJEDISIT JETËSOR

Ndotje kemi atëherë kur në mjedisin ku ne jetojmë gjenden substanca, të cilat janë të dëmshme për shëndetin tonë, si dhe për shëndetin e bimëve dhe të kafshëve. Toka, uji dhe ajri mund të ndotën. Substancat që ndotin mjedisin quhen ndotës. Ato, përveç që dëmtojnë shëndetin, shkaktojnë dëme edhe në objektet ku ne jetojmë.



Gjatë dimrit, në qytete, shpesh ajri është shumë i ndotur. Cilët janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit? Si ndihemi kur ajri është i ndotur? Diskuto me shokë.

Po ashtu, diskuto me shokë dhe shoqe, pse ju nuk duhnet t'i hidhni mbeturinat në ujë dhe në tokë.

4.3

NDOTËSIT E MJEDISIT JETËSOR

Ndotje kemi atëherë kur në mjedisin ku ne jetojmë gjenden substanca, të cilat janë të dëmshme për shëndetin tonë, si dhe për shëndetin e bimëve dhe të kafshëve. Toka, uji dhe ajri mund të ndoten. Substancat që ndotin mjedisin quhen ndotës. Ato, përveç që dëmtojnë shëndetin, shkaktojnë dëme edhe në objektet ku ne jetojmë.



Gjatë dimrit, në qytete, shpesh ajri është shumë i ndotur. Cilët janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit? Si udhëni kar ajri është i ndotur? Diskuto me shokë.

Po ashtu, diskuto me shokë dhe shoqe, pse ju nuk duhet t'i hidhni mbeturinat në ujë dhe në tokë.

torët e ndotjes së mjedisit jetësor. Veprimtaria bëhet në dyshe. Pas përfundimit të veprimtarisë, nxënësit vizatojnë e formulojnë tri fjalë këshilluese për ndotësit e mjedisit.

Për shembull:

1. Fabrikat duhet të jenë në periferi të qytetit.
2. Njerëzit të përdorin biçikleta për lëvizje.
3. Mbeturinat t'i hedhim në shportë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, identifikimin e faktorëve të ndotjes së mjedisit, shpjegimin e rëndësisë së ruajtjes së mjedisit dhe formulimin e tri fjalive këshilluese për ndotësit e mjedisit.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Hapi 2: Shfaqet një video para nxënësve. Aty paraqiten faktorët e ndotjes së mjedisit jetësor, si dhe pasojat e ndotjes për njeriun, bimët dhe kafshët.

Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=oZLBGXLrXcc>

Gjatë shfaqjes së videos, nxënësit identifikojnë ndotësit e mjedisit jetësor. Më pas, kalohet në veprimtarinë e radhës, ku diskutohet rreth temës në fjalë.

Hapi 3: Theksohet se ndotje kemi atëherë kur në mjedisin ku jetojmë gjenden sende, të cilat janë të dëmshme për shëndetin tonë, për bimët dhe kafshët. Sendet që ndotin mjedisin quhen ndotës.

Shtrohen pyetjet:

Cilët ishin ndotësit kryesorë të mjedisit jetësor? A mendoni që njeriu ndikon në ndotjen e mjedisit? Si mund të kontribuojnë njerëzit në ruajtjen e mjedisit jetësor?

Cilat veprime duhen ndërmarrë për mjedis të pastër?

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen fletë, ku do të plotësojnë duke gjetur fjalët që tregojnë faktorët e ndotjes së mjedisit jetësor.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi natyror

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndotësit themelorë të mjedisit, si: mbeturinat, fabrikat, automjetet, ujërat e zeza.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.2; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Riciklo dhe ripërdor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e riciklimit dhe ripërdorimit për tokën;
- Dallon riciklimin nga ripërdorimi;
- Rendit sendet që riciklohen dhe ripërdoren.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të përgjithshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u lexohet një tekst i shkurtër.

- Poli dhe Dea shkuan në piknik. Me vete morën shumë artikuj ushqimorë. Pasi përfunduan piknikun, i mbledhën mbeturinat dhe i futën në një qese plastike. Kur u afruan te shporta e mbeturinave, aty ishin dy të tilla, në njërin shkruante **riciklim**, ndërsa në tjetrën **mbeturina**. Çfarë mendoni ju, në cilën shportë do t'i hedhin mbeturinat fëmijët? As Poli dhe as Dea nuk e kishin idenë se ku duhej t'i hidhnin. Aty pranë kaloi një qytetar. Fëmijët i këkuan ndihmë. Ai filloi të qeshte dhe i ledhatoi me dashuri të dy fëmijët. Të dashur fëmijë, riciklim do të thotë të bësh sende të reja duke përdorur ato të vjetrat, për shembull një shishe qelqi përpunohet dhe krijohet një trup tjetër i ri. Poli dhe Dea e hapën qesen dhe filluan t'i ndanin mbeturinat. Te shporta **riciklim** hodhën kanaçe, shishe plastike, karton etj.

4.4 RIKIKLO DHE RIPËRDOR

Që ta ruajmë tokën dhe burimet natyrore, duhet të përdorim gjëra që mund të përdoren shumë herë ose të riciklohen.

P.sh.: në vend të qeseve plastike (për një përdorim), përdorni qese tekstili, të cilat mund t'i përdorni disa herë, ose në vend të shisheve të plastikës, përdorni shishe të qelqit, sepse ato mund t'i pastroni lehtë dhe t'i përdorni përsëri. Shishta e qelqit, pasi të dëmtohet, mund të shkrihet dhe prej saj të krijohet një shishe tjetër. Procesi kur një objekt (p.sh.: shishta e qelqit) ripërpunohet dhe prej tij krijohet një objekt tjetër quhet **riciklim**.

Përmes riciklimit e mbrojmë mjedisin nga ndotja dhe i ruajmë burimet natyrore të tokës.

Nëse i përdorni gjërat disa herë, kjo do të thotë që ju s'keni nevojë të blini gjëra të reja shpesh. Kështu, mund të kurseni dhe ta ruani mjedisin.



Analizo figurën dhe diskutoni së bashku në klasë për mënyrën e riciklimit të mbeturinave.



4.4 RIKIKLO DHE RIPËRDOR

Që ta ruajmë tokën dhe burimet natyrore, duhet të përdorim gjëra që mund të përdoren shumë herë ose të riciklohen.

P.sh.: në vend të qeseve plastike (për një përdorim), përdorni qese tekstili, të cilat mund t'i përdorni disa herë, ose në vend të shisheve të plastikës, përdorni shishe të qelqit, sepse ato mund t'i pastroni lehtë dhe t'i përdorni përsëri. Shishja e qelqit, pasi të dëmtohet, mund të shkrihet dhe prej saj të krijohet një shishe tjetër. Procesi kur një objekt (p.sh.: shishja e qelqit) ripërpunohet dhe prej tij krijohet një objekt tjetër quhet **riciklim**.

Përmes riciklimit e mbrojmë mjedisin nga ndotja dhe i ruajmë burimet natyrore të tokës.

Nëse i përdorni gjërat disa herë, kjo do të thotë që ju s'keni nevojë të blini gjëra të reja shpesh. Kështu, mund të kurseni dhe ta ruani mjedisin.



Analizo figurën dhe diskutoni së bashku në klasë për mënyrën e riciklimit të mbeturinave.



45

Hapi 2: Shtrohet pyetja:

A mendoni që është i rëndësishëm riciklimi? Pse?

Për ta ruajtur tokën duhet të përdoren gjëra që mund të përdoren shumë herë ose të riciklohen. Përmes riciklimit mbrohet mjedisi nga ndotja dhe ruhen burimet natyrore të tokës. Për ta pasur më të lehtë riciklimin, duhen hedhur mbeturinat në shportën e duhur. Në ditët e sotme shumica e shportave janë me emërtime, si: letër, plastikë, kanaçe dhe qelq. Përveç riciklimit kemi edhe ripërdorimin e sendeve të vjetra.



Simboli me të cilin shënohet riciklimi ka tri shigjeta të cilat kanë tri kuptime që identifikohen si 3R: riciklim, ripërdorim dhe reduktim. Nëse riciklohen dhe ripërdoren sendet e vjetra, atëherë ruhet mjedisi nga ndotja dhe burimet natyrore të tokës.

Hapi 3: Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup do të vizatojë simbolin e riciklimit dhe

do të shkruajë llojin e mbeturinave që duhet të hedhin në shportë. Letrat vendosen në katër shportat e shkollës, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për ruajtjen e mjedisit jetësor. *Shembull:*



Hapi 4: Plotësohet fleta e punës sipas udhëzimeve të dhëna.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, shpjegimin e ndotësve të mjedisit, dallimin e riciklimit nga ripërdorimi, renditjen e saktë të gjërave të riciklueshme dhe të ripërdorshme.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Dielli, burim i jetës në tokë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për rolin e diellit, ajrit dhe ujit për jetën në tokë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 1.7; 2.1;

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Roli i diellit, ajrit, ujit për qeniet e gjalla në Tokë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon qeniet e gjalla dhe jo të gjalla;
- Tregon rolin e diellit, ajrit dhe ujit për tokën;
- Shpjegon rëndësinë e diellit për qeniet e gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Para nxënësve paraqiten dy ilustrime, njëri me qenie të gjalla dhe tjetri me qenie jo të gjalla. Diskutohet me nxënësit rreth tyre. Çfarë po shihni në ilustrime? A kanë dallime njëri me tjetrin? A kanë lidhshmëri njëri me tjetrin? Pra, në ilustrim gjenden qeniet e gjalla (njerëzit, kafshët dhe bimët) dhe qeniet jo të gjalla (makina, kukulla, tavolina, çorape). Qeniet e gjalla lindin, rriten, zhvillohen, ushqehen, plaken (vyshken) dhe vdesin (ngordhin).



Shtrohet pyetja: Cilat janë nevojat kryesore të qenieve të gjalla, që pa to ato nuk mund të jetojnë? Ja një përgjigje e mundshme: Qeniet e gjalla kanë nevojë për ajrin, dritën, diellin dhe ujin.

4.5

ROLI I DIELLIT, I AJRIT DHE I UJIT PËR QENIET E GJALLA NË TOKË

Dielli është ylli më i afërt me Tokën, i cili liron nxehtësi dhe e ngroh atë. Ai ngroh dheun, ajrin, ujin dhe gjithçka tjetër në sipërfaqe të tokës. Dielli ndikon në krijimin e reve, të erës, të shiut etj.

Temperatura dhe matja e saj


Temperatura na tregon se sa i nxehtë apo i ftohtë është një trup. Ne përdorim njësinë *gradë celsius* për ta matur temperaturën.

Instrumenti me të cilin e masim temperaturën quhet *termometër*.



Dielli mund të na shkaktojë dëme!

Nëse rrimë gjatë në diell gjatë verës, lëkura jonë mund të digjet, mund të kemi marramendje, kokëdhembje dhe të vjella. Ne, po ashtu, nuk duhet ta shikojmë drejtpërdrejt diellin, sepse mund të na dëmtohen sytë.



Të gjithë organizmat e gjallë kanë nevojë për dritën dhe nxehtësinë e diellit. Bimët e përdorin energjinë e diellit që të krijojnë ushqim, ndërsa kafshëve energjia e diellit u duhet për t'u ngrohur, si dhe drita e tij për të parë.

Të gjithë organizmat e gjallë (bimët, kafshët dhe njeriu), pas një kohe, vdesin. Trupat e tyre kalben dhe zbrërthehen në materiale, të cilat shfrytëzohen përsëri nga bimët si ushqim.



Duke u bazuar në ilustrimin e mëposhtëm, së bashku me mësuesen/in, sqaro ciklin e qarkullimit të materies.



47

Hapi 2: Theksohet që:

Dielli është ylli më i afërt me Tokën, i cili liron nxehtësi dhe ngroh Tokën; dheun, ujin, ajrin dhe të gjitha sendet në sipërfaqe të tokës.

Uji është burim i jetës. Pa ujë qeniet e gjalla nuk mund të jetojnë.

Pa ajër nuk ka jetë. Ajri na duhet për frymëmarrje.

Hapi 3: Nxiten nxënësit të mendojnë dhe të përgjigjen në pyetjet e shtruara:

- A mund të jetë i dëmshëm dielli për qeniet e gjalla? Nëse po, pse?
- Si ndikon qëndrimi i gjatë në diell në organizimin e njeriut?
- A pajtoheni me mendimet e nxënësve? Pse?

Nëse qëndrojmë gjatë në diell në stinën e verës, lëkura jonë mund të digjet, mund të kemi marramendje, të vjella, sytë dëmtohen nëse shikojmë pa syze në drejtim të diellit etj. Kur organizmi i njeriut nuk është mirë, mund të ketë temperaturë. Temperaturën e trupit e matim me termometër.

Hapi 4: Shpjegohet rëndësia e diellit për tokën si dhe ciklin e qarkullimit të lëndës.

Dielli i jep dritë dhe ngrohtësi tokës. —> Bimët e marrin energjinë nga dielli dhe krijojnë ushqim. —> Me bimë ushqehen kafshët. —> Njerëzit e marrin ushqimin nga bimët dhe kafshët.

Hapi 5: Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në fletë pune.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla, shpjegimin e rolit të diellit, ujit, ajrit për tokën, rëndësinë e diellit për qeniet e gjalla dhe plotësimin e saktë të fletës së punës.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Marrëdhëniet jetësore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të gjalla.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2; III.3; V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Të gjithë organizmat e gjallë kanë nevojë për ujë!

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon nevojat jetësore të organizmave të gjallë;
- Tregon rëndësinë e ujit për bimët;
- Përshkruan rolin e ujit në organizmin e njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, laptop, shishe plastike, dhe, ujë, farë bime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Ora e mësimimit fillon me paraqitjen e një videoje të marrë nga interneti. Aty tregohet rëndësia e ujit për qeniet e gjalla. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=rUQEm3UYu5M> Diskutohet me nxënësit për rëndësinë e ujit për qeniet e gjalla.

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat. Ata shikojnë ilustrimet e paraqitura dhe i përshkruajnë me fjali të thjeshta.

Pas përshkrimit të ilustrimeve, kërkohet të plotësohet teksti me fjalitë e duhura në libër.

Për ujë kanë nevojë: njerëzit, _____.



Për ujë kanë nevojë: _____

Uji në trupin e njeriut


Të gjitha gjallesat përbëhen nga një pjesë e madhe e ujit. Për shembull, 75% e trupit tonë është ujë.

Uji gjendet në organe, gjak, muskuj dhe në eshtra. Njeriut, për një ditë, i nevojiten 2-4 litra ujë, varësisht prej aktiviteteve që bën.

Se sa ka nevojë trupi yt për ujë, këtë më së miri mund ta kuptosh pas aktivitetit sportiv, kur ke eufje. Ujin mund ta marrim përmes pirjes së ujit apo përmes ushqimeve të ndryshme.

Pa ujë, njerëzit dhe kafshët do të vdisnin, ndërsa bimët do të thaheshin.

Për këtë arsye ne themi se uji është burim i jetës.




Njeriu mund të jetojë deri në 20 ditë pa ushqim, por më së tepërmi deri në 4 ditë pa ujë.

Bimët nuk mund të jetojnë pa ajër. Ajri u duhet bimëve për frymëmarrje, si dhe për të krijuar ushqim.

Njerëzve dhe kafshëve, po ashtu u nevojitet ajri për frymëmarrje.



49




Hapi 3: Zhvillohet një eksperiment me tërë klasën. Mbillen dy bimë, njëra ujitet vazhdimisht, kurse tjetra jo. Pas dy javësh do të vërehet dallimi në mes dy bimëve dhe rëndësia e ujit për rritjen e tyre.

1. Marrim një shishe plastike, i hapim tri vrima poshtë shishes.
2. Në shishe e vendosim dheun.
3. Në dhe e vendosim farën e bimës.
4. Më pas njërin shishe e ujitim, kurse tjetrën jo.
5. Dy shisheet vendosen në dritare ku ka rreze dielli.

Hapi 4: Kalohet në veprimtarinë e radhës duke bërë pyetje: Trupi i njeriut, a ka nevojë për ujë? Nëse po, pse?

Pas diskutimit shfaqet një video tjetër pa zë, ku tregohet rëndësia e ujit për trupin e njeriut. Gjatë shfaqjes së videos jepen sqarime për ilustrimet. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=69B0gVSfnY>.

Hapi 5: Nxënësit të ndarë në dyshe i paraqesin në fletë A4, në formë harte, informacionet e marra nga videoja.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, tregimin e rëndësisë së ujit për organizmat e gjallë, përshkrimin e rolit të ujit në organizmin e njeriut.

Detyrë:

Plotësim në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Dielli, burim i jetës në tokë

Rezultatet e të nxënimit të temës:

Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4,II.1,II.2,III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5,2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimet ditë-natë

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Dallon ditën nga nata;
- Përcakton lëvizjen e diellit të tokës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Pyeten nxënësit:

- Në cilin planet jetojmë?
- Çfarë forme ka toka, si mendoni ju?
- Sa muaj ka viti?
- Po java sa ditë ka?
- Sa orë i ka një ditë?

Hapi 2: Pas përgjigjeve të marra, hapen librat, shpjegohet mësimi, më pas përmes projektorit shfaqet një video ku flitet për tokën, diellin, hënën, ditën dhe natën. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=Wf-CRkSTYGs>.

4.7

NDRYSHIMET DITË-NATË

Planeti Tokë ka formë elipsoide, pra të rumbullakët, por të shtypur në të dyja polet. Toka sillet vazhdimisht rreth boshtit të vet; ky rrotullim zgjat 24 orë. Kjo bën që të ketë ditë dhe natë në planetin tonë. Ditë është kur pjesa e Tokës ku gjendemi ne është e kthyer kah Dielli, ndërsa natë është atëherë kur pjesa e Tokës ku gjendemi ne është e kthyer në anën e kundërt. Gjatë ditës, një pjesë e Tokës i ekspozohet Diellit, ndërsa pjesa që gjendet në anën tjetër është e errët, pra është natë. Prandaj Diellin nuk mund ta shohim natën, sepse ai gjendet në anën e kundërt me vendin ku jetojmë.



Pse duket që Dielli lëviz?

Kur shikojmë qiellin, Dielli duket se lëviz nga njëri skaj te skaji tjetër i qiellit, por në të vërtetë, Toka është ajo që lëviz dhe, meqë ne jetojmë në Tokë, vetëm na duket se Dielli lëviz.

Lindja dhe perëndimi i diellit

Dielli lind çdo ditë, qielli bëhet i ndritshëm. Dielli duket se lëviz përgjatë qiellit gjatë ditës; ai perëndon në mbrëmje dhe qielli bëhet i errët. Por, kjo është vetëm ajo çka ndodh gjatë një rrotullimi të plotë të Tokës rreth boshtit të vet, i cili zgjat 24 orë.



Diskuto, së bashku me shokët dhe shoqet dhe mësuesin/en, pse ndodh ndryshimi ditë-natë.

50

47

NDRYSHIMET DITË-NATË

Planeti Tokë ka formë elipsoide, pra të rumbullakët, por të shtypur në të dyja polet. Toka sillet vazhdimisht rreth boshtit të vet; ky rrotullim zgjat 24 orë. Kjo bën që të ketë ditë dhe natë në planetin tonë. Ditë është kur pjesa e Tokës ku gjendemi ne është e kthyer kah Dielli, ndërsa natë është atëherë kur pjesa e Tokës ku gjendemi ne është e kthyer në anën e kundërt.



Gjatë ditës, një pjesë e Tokës i ekspozohet Diellit, ndërsa pjesa që gjendet në anën tjetër është e errët, pra është natë. Prandaj Diellin nuk mund ta shohim natën, sepse ai gjendet në anën e kundërt me vendin ku jetojmë.

Pse duket që Dielli lëviz?

Kur shikojmë qiellin, Dielli duket se lëviz nga njëri skaj te skaji tjetër i qiellit, por, në të vërtetë, Toka është ajo që lëviz dhe, meqë ne jetojmë në Tokë, vetëm na duket se Dielli lëviz.

Lindja dhe perëndimi i diellit


Dielli lind çdo ditë, qielli bëhet i ndritshëm, Dielli duket se lëviz përgjatë qiellit gjatë ditës; ai perëndon në mbrëmje dhe qielli bëhet i errët. Por, kjo është vetëm ajo çka ndodh gjatë një rrotullimi të plotë të Tokës rreth boshtit të vet, i cili zgjat 24 orë.



Diskarto, së bashku me shokët dhe shoqet dhe mësuesin/en, pse ndodh ndryshimi ditë-natë.

Diskutohet:

- Çfarë e shkakton ndërrimin e ditës dhe natës?
- A e dini ju se te ne tani është ditë, por në Zelandën e Re është natë?



- Si mendoni ju, kur e shikoni qiellin, pse dielli lëviz?
- Pse nuk mund ta shohim diellin natën?

Hapi 3: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen materialet e nevojshme për rrotullimin e tokës rreth boshtit të vet. Në të njëjtën kohë jepet informacioni përsëritës për fjalën e panjohur duke treguar se rrotullimi është ndërrimi ditë-natë dhe anasjellas.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, dallimin mes ditës dhe natës, përcaktimin e lëvizjes së diellit dhe të tokës dhe për pjesëmarrjen në diskutim.

Detyrë:

Reflektim për rrezjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Dielli, burim i jetës në tokë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7,III.2,III.3,VI.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5,2.1,2.2,2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Katër stinët e vitit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon mënyrën e ndërrimit të stinëve të vitit;
- Identifikon ndryshimet që ndodhin me ndërrimin e stinës;
- Specifikon muajt nëpër stinë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Glob, pëlhurë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Shkathhtësi për jetë, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Bëhet përsëritje e shkurtër mbi njësinë e kaluar. Zhvillohet diskutimi. Pyeten nxënësit:

- Çfarë ndryshime kemi kur Toka sillet rreth boshtit të vet?
- Sa muaj ka viti dhe cilët janë ata?
- Po viti, sa stinë ka?

Hapi 2: Diskutohet mbi atë se Toka përveç se sillet rreth boshtit të vet, ajo sillet edhe rreth Diellit. Rruga që bën toka rreth Diellit quhet orbitë dhe zgjat për 365 ditë ose 1 vit të plotë (12 muaj). Ajo shkakton ndërrimin e stinëve të vitit. Më pas nxënësve u kërkohet që të plotësojnë librin duke i shkruar muajt e vitit në vendin përkatës.


48

KATËR STINËT E VITIT

Si ndërrohen stinët?

Toka, pos që sillet rreth boshtit të vet (ku kemi ndërrimet ditë-natë), ajo sillet edhe rreth Diellit. Rruga që bën Toka rreth Diellit quhet orbitë dhe këtë rrugë Toka e bën për rreth 365 ditë (një rrotullim i plotë i Tokës rreth Diellit). Ky rrotullim i Tokës rreth Diellit shkakton ndërrimin e stinëve të vitit.

Shkruani stinët dhe muajt e vitit në figurë.



Stinë:

- pranvera;
- vera;
- vjeshta;
- dimri.

Muajt:

- janar, shkurt, mars, prill,
- maj, qershor, korrik,
- gusht, shtator, tetor,
- nëntor, dhjetor.



Diskuto me mësuesin/en për ndryshimin e klimës përgjatë stinëve të vitit.


4.8

KATËR STINËT E VITIT

Si ndërrohen stinët?

Toka, pos që sillet rreth boshllit të vet (ku kemi ndërrimet ditë-natë), ajo sillet edhe rreth Diellit. Rruga që bën Toka rreth Diellit quhet orbitë dhe këtë rrugë Toka e bën për rreth 365 ditë (një rrotullim i plotë i Tokës rreth Diellit). Ky rrotullim i Tokës rreth Diellit shkakton ndërrimin e stinëve të vitit.

Shkruani stinët dhe muajt e vitit në figurë.



Stinët:
- pranvera;
- vera;
- vjeshta;
- dimri.

Muajt:
janar, shkurt, mars, prill,
maj, qershor, korrik,
gusht, shtator, tetor,
nëntor, dhjetor.




Diskuto me mësuesin/en për vdrshimin e klimës përgjatë stinëve të vitit.



E rrotullojmë globin rreth stinëve, duke vërejtur në këtë mënyrë ndërrimin e tyre gjatë vitit.

Hapi 3: Nxënësit të ndarë në katër grupe punojnë stinën e caktuar dhe tregojnë muajt që ato përfshijnë. P.sh. Grupi i Diellit do të punojë stinën e verës dhe do të tregojë që vera përfshin muajt nga 21 qeshori, korrikun, gushtin e deri më 21 shtator. Grupi i lules do të punojë stinën e pranverës. Ndërsa grupi i ombrellës do të punojë stinën e vjeshtës.

Grupi i babadimrit do të punojë stinën e dimrit. Në fund punimet e bëra vendosen në murin e klasës.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për shpjegimin e shkakut të ndërrimit. Të stinëve dhe ndryshimet që ndodhin gjatë procesit.

Detyrë:

Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Dielli, burim i jetës në tokë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,I.7,II.1,II.7,III.2,III.3,I V.1,IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.7,2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Po përfundon viti shkollor!

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan veprimtaritë që i pëlqejnë dhe nuk i pëlqejnë t'i bëjë gjatë pushimeve;
- Harton tekstin për një kartolinë drejtuar shokut a shoqes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Top, fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të bëjnë rrethin dhe të luajnë lojën me top. Cilido që e pret topin duhet të përgjigjet në pyetjet:

- Si keni planifikuar që t'i kaloni pushimet verore?
- A keni familjarë në fshat apo bregdet?
- A do t'i kalojë ndonjëri nga ju pushimet në kampin veror?

Hapi 2: Hapen librat dhe diskutohet rreth propozimeve që janë radhitur aty. Më pas u shpërndahen fletët e përgatitura ku ata shkruajnë se si dhe ku do t'i kalojnë pushimet, dhe çfarë aktivitete do të bëjnë?

PO PËRFUNDON VITI SHKOLLOR!

Ka shumë gjëra që mund t'i bësh gjatë pushimit të verës! Këtu mund t'i lexosh disa propozime. Radhiti në tabelë sipas asaj se çka të pëlqen të bësh më shumë e çka më pak.



Të shkoj për pushim në bregdet; Të rri në shtëpi; Të lexoj një libër; Të notoj; Të vizitoj një muze; Të vizitoj shokët e shoqet; Të shkoj në kinema; Të lundroj me anije; T'u shkruaj letra shokëve e shoqeve të mia; Të vizatoj; Të shëtit në mal; Të shikoj TV; Të luaj lojëra në kompjuter; Të përgatis ushqimin; Të vizitoj gjyshin dhe gjyshen etj.

Unë gjatë pushimit dëshiroj:

Mua gjatë pushimit nuk më pëlqen:



Planifiko t'i shkruash ndonjë shokut apo shoqejë të klasës një kartolinë apo letër. Pyete shokun apo shoqen për adresën!

PO PËRFUNDON VITI SHKOLLOR!

Ka shumë gjëra që mund t'i bësh gjatë pushimit të verës! Këtu mund t'i lexosh disa propozime. Radhiti në tabelë sipas asaj se çka të pëlqen të bësh më shumë e çka më pak.



Të shkoj për pushim në bregdet; Të ri në shtëpi; Të lexoj një libër; Të notoj; Të vizitoj një muze; Të vizitoj shokët e shoqet; Të shkoj në kinema; Të lundroj me anije; T'u shkruaj letra shokëve e shoqeve të mia; Të vizitoj; Të shëtis në mal; Të shikoj TV; Të luaj lojëra në kompjuter; Të përgatis ushqimin; Të vizitoj gjyshin dhe gjyshen etj.

Unë gjatë pushimit dëshiroj:

Mua gjatë pushimit nuk më pëlqen:



Planifiko t'i shkruash ndonjë shokut apo shoqejë të klasës një kartolinë apo letër. Pëqete shokun apo shoqen për adresën!


52



Më pas bëhet shkëmbimi i punimeve të tyre dhe nxënësit lexojnë idetë e shokut a shoqes.

Hapi 3: Në libra plotësohen tabelat dhe nxënësit tregojnë se çfarë u pëlqen dhe çfarë nuk u pëlqen të bëjnë gjatë pushimeve verore. Pas plotësimit të detyrës, jepen këshilla për hartimin e tekstit për një kartolinë drejtuar shokut a shoqes.

Ja një metodë se si mund të punohet një kartolinë.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e veprimtarive në pushimet verore dhe hartimin e tekstit për shkrimin e kartolinës.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

